

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6187
E enjte, 10 dhjetor 2020
çmimi 0.40

BE-ja kërkon nga Kosova
rritje të përpjekjeve për
sundim të ligjit, s'ka asgjë të
re për liberalizim vizash



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SUBJEKTET POLITIKE, LARG ARRITJES SË KONSENSUSIT
PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI ■ FAQE 4-5

VENDI PO SHKON DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA

Partitë politike nuk po tregojnë vullnet politik për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit. Në qëndrimet e tyre publike këto subjekte kanë bërë me dije se janë larg arritjes së një konsensusi për këtë çështje. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, i cili kishte paralajmëruar një tryezë të partive për këtë çështje, ka përmendur mundësinë e dështimit të kësaj iniciative. Ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja vazhdojnë të insistojnë në të drejtën e tyre për ta pasur presidentin, kurse lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë se Kosova ka nevojë për rilegjitimim të institucioneve përmes zgjedhjeve të reja



OPINION

TRIBUNALI SPECIAL,
PRODUKT I NJË
MASHTRIMI (1) F. 6, 7, 8, 9, 10

Serge
MÉTAIS



HARRUARJE PËRTËRITJEJE
E (PA)QËLLIMSHME F. 13

Shkruan
Agron HOTI



AKTUALE

KOSOVA SHËNON EDHE
11 VIKTIMA DHE 561 RASTE TË
REJA ME KORONAVIRUS F. 11

MUNGESA E OKSIGJENIT
DHE BARNAVE NËPËR SPITALE
PO U KUSHTON ME JETË
QYTETARËVE F. 6

INSTITUCIONET E DREJTËSISË
DHE EULEX-I, NJËZËRI NË
LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT F. 8

EKONOMI

GJERMANIA IA JEP KOSOVËS
72.1 MILIONË EURO, PREJ TYRE
34 MILIONË EURO GRANTE F. 8

KRU 'HIDRODINI':
NDËRPRERJET E ENERGJISË
ELEKTRIKE KANË SHFAQUR
EDHE SHKURTIMET PËR
FURNIZIM ME UJË F. 8

SERBIA TA PRANOJË GJENOCIDIN KUNDËR SHQIPTARËVE TË KOSOVËS



Përfaqësuesit e shoqatave të familjarëve të personave të pagjetur u kanë bërë thirrje institucioneve të bëjnë më shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Ata nga foltorja e Kuvendit e Kosovës kanë kërkuar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare t'i bëjnë presion Serbisë në lidhje me këtë çështje. Ndërsa kryeparlamentarja Vjosa Osmani ka thënë se mospranimi i fajit nga Serbia është duke e mbajtur peng dialogun me

Serbinë. Ajo ka theksuar se Serbia duhet të detyrohet të japë informata për të pagjeturit dhe për gjitha krimet që ka bërë në Kosovë. Në anën tjetër, kryeministri Avdullah Hoti ka kërkuar nga Serbia të kërkojë falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë. Po ashtu, ai ka kërkuar nga Serbia të kërkojë falje edhe për djegien e kufomave të civilëve shqiptarë; për varrosjen dhe zhvarrosjen e disahershme të tyre ■ FAQE 11

MË 17 DHJETOR SEANCA E RADHËS NË GJYKATËN
SPECIALE NDAJ KRERËVE TË UÇK-së ■ FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOV.
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtin, Kosov*,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Merkeli shpallet gruaja më e fuqishme në botë



BERLIN, 9 DHJETOR - Revista amerikane "Forbes" ka publikuar emrat e grave më të fuqishme në botë për vitin 2020 teksa ka theksuar se ndikimi ekonomik dhe shoqëror i pandemisë së koronavirusit ka prekur në mënyrë joproporcionale gratë. Në krye të listës këtë vit është kancelarja gjermane Angela Merkel, e pasuar nga presidentja e Bankës Qendrore Evropiane, Christine Lagarde.

Përveç tyre, në pesë pozitë e para renditen edhe nënpresidentja e zgjedhur amerikane Kamala Harris, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen dhe filantropja amerikane Melinda Gates. "Lideret e listës së 100 grave më të pushtetshme në botë e revistës 'Forbes' luajnë rol tejet të rëndësishëm në të përcaktuarit e asaj se si do të duket bota pas pandemisë. Fuqia e tyre kalon

përtej fushave ekonomike dhe politike, për ta transformuar industrinë dhe për t'i zgjidhur çështjet më urgjente shoqërore. Fuqia e tyre për të na çuar përpara nuk ka qenë kurrë më e nevojshme", është thënë në deklaratën e revistës që ka renditur emrat. Nga pozita e pestë dhe në dhjetë, "Forbes" ka përmendur këta emra, Mary Barra, Nancy Pelosi Ana Patricia Bioton, Abigail Johnson dhe Gail Bourdreaux.

Bideni zotohet për 100 milionë vaksina në 100 ditët e para të udhëheqësisë

WASHINGTON, 9 DHJETOR - Presidenti i zgjedhur amerikan, Joe Biden, ka prezantuar synimin e tij për 100 miliona vaksina për koronavirus, në 100 ditët e para të udhëheqësisë së tij. Ai ka thënë se muajt e tij të parë në zyrë nuk do ta ndalin pandeminë dhe ka dhënë detaje për planin e vaksinimit, mirëpo ka thënë se do ta ndryshojë kursin e sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusin. "Njëqind ditët e mia të para nuk do ta ndalin koronavirusin. Nuk mund të premtoj për këtë, mirëpo nuk

jemi përfshirë në këtë kaos shpejt. Nuk do të dalim shpejt", ka thënë ai nga vendlindja e tij në Delauer.

Teksa ka prezantuar ekipin e tij shëndetësor kur ta marrë detyrën më 20 janar, ai u ka bërë thirrje amerikanëve "që të vendosin maska për 100 ditë".

Të martën një raport i ka hapur rrugën kompanisë amerikane "Pfizer" dhe asaj gjermane "BioNTech" për miratim të vaksinave për amerikanët.

Autorizimi urgjent për vaksinim, nëse miratohet, nënkupton se imunizimi i

njerëzve mund të nisë nga java e ardhshme.

Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar më shumë se 15 milionë raste dhe 285 000 viktima me koronavirus, sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins".

Shumë pjesë të territorit amerikan janë duke raportuar për shifra rekorde të infektimit dhe atyre që janë të shtrirë në spital. Shumë ekspertë janë duke fajësuar udhëtimet e miliona personave për Festën e Falënderimeve për rritjen e shpejtë të infektimit.



Mali Everest 'rritet' për gati një metër

PEKIN, 9 DHJETOR - Mali më i lartë në botë Everest është për 86 centimetra më i lartë, njoftuan Nepali dhe Kina. Deri më tani dy vendet nuk janë pajtuar nëse duhet të shtojnë ose jo kapakun e borës sipër.

Autoritetet kineze kanë thënë se mali është i lartë aq sa lartësia e tij shkëmbore, ndërsa autoritetet e Nepalit



kanë argumentuar se duhet përfshirë edhe bora në majë. Lartësia e re e malit është 8,848.86 metra.

Matja e mëparshme zyrtare e Kinës ka qenë 8,844.43 metra, apo katër metra më e ulët se ajo e Nepalit. Everesti shtrihet në kufirin midis Kinës dhe Nepalit dhe alpinistët ngjiten në majë të tij nga të dyja anët. Zyrtarët e Ministrisë së

Jashtme të Nepalit dhe të Departamentit të Matjeve thanë se topografët e të dyja vendeve kanë rënë dakord për lartësinë e re. Marrëveshja për të njoftuar bashkërisht për matjen e re të pikës më të lartë në Tokë është bërë gjatë vizitës së presidentit të Kinës, Xi Jinping, në kryeqytetin e Nepalit, Kathmandu, vitin e kaluar.

Ekipi ligjor i Trumpit vazhdon luftën për përmbyse të rezultatit zgjedhor

WASHINGTON, 9 DHJETOR - Ekipi ligjor i presidentit aktual amerikan Donald Trump planifikon ta vazhdojë luftën për përmbyse të rezultateve, pavarësisht vendimit të Gjykatës Supreme, e cila ka refuzuar përpjekjet për ta kthyer mbrapsht fitoren e Joe Bidenit në Pensilvani. Vendimi i



Gjykatës Supreme më 8 dhjetor ka qenë humbje e madhe për përpjekjet e Trumpit, ekipit

ligjor dhe aleatëve të tij republikanë, që kanë nisur një varg padish për ta përmbytur rezultatit zgjedhor.

Gjykata ka kundërshtuar padinë për rezultatet në Pensilvani pa ndonjë koment. Kjo ka qenë një prej padive që ekipi i Trumpit ka dërguar në gjykatën më të lartë në Shtetet e

Bashkuara. Kjo gjykatë ka shumicë konservatore 6-3, duke përfshirë tre të emëruarit e Trumpit.

Prokurori i Përgjithshëm i Pensilvanisë, Josh Shapiro, demokrat, ka thënë përmes një postimi në rrjetin "Twitter", se vendimi "dërgon mesazh të qartë", duke shtuar se "është

koha për të vazhduar më tutje". Trumpi ka pretenduar, pa ofruar argumente se ka fituar zgjedhjet, duke thënë se ka pasur mashtrime zgjedhore.

Gati të gjitha paditë e dërguara nga fushata e Trumpit dhe aleatët e tij janë hedhur poshtë nga gjykatat në gjithë territorin amerikan.

Gjenerali i pensionuar Lloyd Austin pritet të jetë sekretar i Mbrojtjes

WASHINGTON, 9 DHJETOR - Presidenti i zgjedhur amerikan Joe Biden ka përmendur emrin e gjeneralit të pensionuar ushtarak Lloyd

Austin, si të zgjedhurin e tij për Sekretar të Mbrojtjes. Nëse miratohet nga Senati, Austin, 67-vjeçar, do të jetë afrikano-amerikani i parë që

do ta drejtojë Pentagonin. "Përgjatë shërbimit të tij të dedikuar dhe për shumë kohë që kemi kaluar në Shtëpinë e Bardhë dhe me

trupat tanë jashtë shtetit, gjenerali Austin ka treguar udhëheqësi shembullor, karakter dhe komandë", ka thënë Bideni në deklaratën e

tij. "Ai është tejet i kualifikuar për t'u përballur me sfidat dhe krizat që kemi aktualisht", ka deklaruar Bideni.

Parlamenti Evropian do të kërkojë sërish nga pesë vendet e BE-së që ta njohin Kosovën

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Parlamenti Evropian (PE) sërish do t'u bëjë thirrje pesë vendeve të Bashkimit Evropian (BE), që nuk e kanë njohur Kosovën, që ta bëjnë një gjë të tillë sa më shpejt. Kjo ftesë e PE-së përsëritet në draft-raportin për Kosovën, të përgatitur në Komisionin e Politikës së Jashtme nga raportuesja për Kosovën, Viola von Cramon. Kjo thirrje nuk është e re, pasi Parlamenti Evropian vazhdon të jetë i vetmi institucion i BE-së që nga fillimi i referohet Kosovës si shtet dhe vazhdimisht kërkon nga shtetet anëtare që ta njohin shtetësinë e Kosovës. "Merret në dijeni se pesë shtetet anëtare ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe përsëritet thirrja ndaj atyre që ta bëjnë këtë; nënvizohet se njohja do të ishte në dobi të normalizimit të raporteve mes Kosovës dhe Serbisë", theksohet në këtë dokument.

Ky raport përfshin një periudhën dyvjeçare, pasi në vitin 2019 nuk ka pasur raport të Parlamentit Evropian sepse ishte vit i zgjedhjeve evropiane dhe pritej konstituimi i përbërjes së re të PE-së.

Në draft-raport thuhet se Kosova po vazhdon të vuajë nga jostabiliteti politik, sidomos pas zgjedhjeve parlamentare të tetorit të vitit 2019.

Nga Kosova kërkohet që t'i shtojë përpjekjet për t'i adresuar problemet në fushën e

sundimit të ligjit, të drejtat themelore, funksionimin e institucioneve dhe zhvillimin ekonomik. Aty, po ashtu, shprehet keqardhje për shuarjen e task-forcës anti-korrupsion brenda Policisë së Kosovës.

Raporti nënvizon se Kosova vazhdon të jetë i vetmi shtet i rajonit të Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilit kanë nevojë për viza për të udhëtuar në zonën Shengen, edhe pse Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave që në vitin 2018.

Prandaj me këtë raport, bazuar në draft-tekstin e tij, eurodeputetët mirëpresin përsëritjen e qëndrimit të Komisionit Evropian se Kosova mund të përfitojë nga liberalizimi i vizave dhe i bëjnë thirrje Këshillit që urgjentisht të lëvizë drejt vendosjes së regjimit pa viza për qytetarët e Kosovës.

Parlamenti Evropian, përmes këtij raporti, kërkon nga Kosova që t'i shtojë përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe të dëshmojë më shumë vullnet politik edhe për përmbushjen e kushteve të caktuara me agjendën e reformave evropiane (ERA).

Në këtë tekst shprehet keqardhje për vendimin e Qeverisë së Kosovës për ta shuar Ministrinë e Integritimit Evropian, por kërkohet që strukturat e reja të kenë nivel të duhur të kompetencave, në mënyrë që të jenë në gjendje ta koordinojnë procesin e



integritimeve.

Një pjesë e konsiderueshme e raportit të përpiluar nga PE-ja i kushtohet dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. PE-ja, thuhet në raport, mirëpret rinisjen e dialogut dhe përkushtimin e shprehur nga të dyja vendet për këtë proces. Prishtina dhe Beogradi zyrtar ftohen që ta vazhdojnë angazhimin konstruktiv në kërkim të marrëveshjes gjithëpërfshirëse, por edhe t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura deri më tash.

Po në raport thuhet se merret në dijeni marrëveshja e arritur në Uashington më 4 shtator për

normalizimin e marrëdhënieve ekonomike dhe nënvizohet se bashkëpunimi transatlantik është faktor kyç në stabilitetin në rajon.

Në këtë dokument kërkohet më shumë përpjekje për ta zbuluar fatin e personave të pagjetur që nga lufta e fundit në Kosovë. Aty, po ashtu, përsëritet mbështetja për krijimin e komisionit rajonal për faktet e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë (RECOM). "Bëjmë thirrje për përpjekje më të mëdha për shqyrtimin e kërkesave të familjarëve të personave të

pagjetur, hapjen e arkivave të luftës dhe zbulimin e të dhënave për personat të cilët ende janë të listuar si të zhdukur nga periudha e luftës 1998-99 në Kosovë", thuhet në dokument.

Raporti është draftuar nga raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon. Për të do të debatohet së pari në Komisionin e Jashtëm të Parlamentit Evropian, ku do të votohet si raport, pastaj do të debatohet dhe miratohet edhe si rezolutë e Parlamentit Evropian gjatë një seance plenare.

Më 17 dhjetor seanca e radhës në Gjykatën Speciale ndaj krerëve të UÇK-së



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Gjykata Speciale ka vendosur që më 17 dhjetor të mbahet seanca e radhës për ecurinë e çështjes ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit.

Sipas një njoftimi të publikuar në uebfaqen e Speciales, gjyqtari i procedurës paraprake ka kërkuar nga prokuroria dhe mbrojtja t'i dërgojnë parashtrësat e tyre deri më 14, përkatesisht 15 dhjetor.

Ditë më parë Dhomat e Specializuara të Gjykatës Speciale kanë publikuar vendimin e aktakuzës së plotë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët akuzohen për

krime lufte.

Vendimi për konfirmim të aktakuzës sipas dokumentit është marrë më 26 tetor të këtij viti, mirëpo është publikuar vetëm më 30 nëntor.

Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi ishin arrestuar dhe dërguar në Hagë në fillim të muajit nëntor. Aktakuza ndaj tyre është e përpiluar në 236 faqe.

Ndër të tjera, në pikat e aktakuzës ndaj tyre rëndon aktakuza për krime, vrasje, tortura në lokacione si Likoc, Jabllanicë, Llapushnik, Volljakë, Drenoc, Malishevë, Bajgorë, Llapashiticë, Majac, Zllash dhe të tjera.

Në këtë version të plotë, Dhomat e Specializuara kanë publikuar data, vende dhe raste specifike, sipas saj, të kryerjes së krimeve.

SUBJEKTET POLITIKE, LARG ARRITJES SË KONSENSUSIT PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË RI

VENDI PO SHKON DREJT ZGJEDHJEVE TË REJA



Partitë politike nuk po tregojnë vullnet politik për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit. Në qëndrimet e tyre publike këto subjekte kanë bërë me dije se janë larg arritjes së një konsensusi për këtë çështje. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, i cili kishte paralajmëruar një tryezë të partive për këtë çështje, ka përmendur mundësinë e dështimit të kësaj iniciative. Ndërsa PDK-ja dhe AAK-ja vazhdojnë të insistojnë në të drejtën e tyre për ta pasur presidentin, kurse lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka thënë se Kosova ka nevojë për rilegitimim të institucioneve përmes zgjedhjeve të reja

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Tryeza e paralajmëruar e partive politike për të diskutuar për çështjen e presidentit është drejt dështimit pasi që subjektet politike nuk po tregojnë vullnet për ta zgjedhur presidentin e ri të vendit. Në qëndrimet e tyre publike, AAK-ja dhe PDK-ja kanë deklaruar se do të votonin për president vetëm nëse ai është kandidat i tyre. Në mungesë të këtij vullneti, liderët e partive politike kanë bërë me

dije se vendi po shkon drejt zgjedhjeve të reja.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, i cili ka nisur iniciativën për tryezën e partive politike, ka pranuar se ajo mund të dështojë. Sipas tij, nëse nuk arrihet një konsensus për këtë temë, vendi do të shkojë në zgjedhje. "Ka deklarata dhe këmbëngulje publike se votojnë vetëm kandidatin e tyre për president dhe jo të një subjekti tjetër. Kjo dëshmon se beteja po zhvillohet në media dhe në debate, por se akoma nuk ka gatishmëri për

tryezë. Koha po ikën dhe po rrëshqasim në zgjedhje", ka thënë Mustafa për "Telegrafin". Kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj, të mërkurën edhe një herë ka treguar se kjo parti nuk mund të shantazhohet për çështjen e presidentit. "Partia Demokratike e Kosovës nuk shantazhohet dhe as nuk do të lejojë që dikush ta marrë peng shtetin e Kosovës. Jemi të gatshëm që te ulemi dhe te bisedojmë me çdo parti politike parlamentare që ta tejkalojmë krizën institucionale në vend

dhe ta zgjedhim një president dinjitoz që i shërben unitetit të brendshëm dhe thellon partneritetin me aleatet tanë. Por, PDK-ja nuk do të behet pale e një procesi që do të prodhonte një president që thellon përçarjen e brendshme dhe e izolon Kosovën jashtë", ka shkruar Hoxhaj në profilin e tij në "Facebook".

Sipas tij, barrikadimi i partive politike pas emrave individualë ende pa filluar procesi është i dëmshëm. "Republika jone është mbi interesat politike dhe egot personale. Kushdo që kërkon votat e deputeteve të PDK-së në Kuvendin e Kosovës, duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmone, që ne atë propozim e ka brenda edhe kandidatin e PDK-së. Barrikadimi pas propozimeve individuale, ende pa filluar një diskutim politik ndërmjet partive parlamentare, është i dëmshëm dhe nuk e ndihmon tejkalimin e krizës, por vetëm thellimin e saj", ka shkruar

Hoxhaj.

Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili mendon se presidentin duhet ta zgjedhë legjislatura e re, ka vlerësuar se Kosova ka nevojë për rilegitimim të institucioneve përmes zgjedhjeve të reja.

Gjatë një takimi virtual me drejtorin e Global Europe Progam, në kuadër të Wilson Center me bazë në ShBA, Daniel Hamilton, ai ka folur edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. "Situata në Ballkanin Perëndimor dhe dialogu me Serbinë ishin, po ashtu, ndër temat kryesore të takimit. Aty paraqita qëndrimin tonë se dialogu duhet të jetë parimor dhe i definuar mirë, se Kosova ka nevojë për rilegitimim të institucioneve përmes zgjedhjeve të reja, kurse Serbia ka nevojë për demokratizim dhe ballafaqim me të kaluarën. Gjithashtu, theksova se nuk duhet të synohet medoemos një përmblyllje e shpejtë e dialogut,

por duhet t'i japim përparësi përmbajtjes, transparencës dhe gjithëpërfshirës”, ka shkruar Kurti në profilin e vet në “Facebook”.

Zgjedhjet mund të mbahen në muajin shkurt

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se nëse subjektet politike nuk merren vesh për zgjedhjen e presidentit atëherë vendi duhet t'i organizojë zgjedhjet në muajin shkurt. Analisti politik Ramush Tahiri ka deklaruar për “Epokën e re” se partitë politike sa më shpejt duhet të tentojnë ta gjejnë një marrëveshje për këtë çështje. “Nëse nuk zgjedhet presidenti deri më 5 janar, atëherë duhet të shpërndahet Kuvendi dhe vendi të shkojë në zgjedhje brenda 45-ditësh. Pra, i bie që nëse partitë nuk merren vesh deri më 5 janar, vendi shkon në zgjedhje në muajin shkurt. Sipas asaj që unë e interpretoj Kushtetutën, presidenti i vendit duhet të zgjedhet në afat prej dy muajve,

pra nga data e dorëheqjes e jo brenda gjashtë muajve qysh po thonë disa”, ka thënë Tahiri. Sipas tij, nuk do të ishte mirë që vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues detyre të postit të presidentit. “Dëshiroj që kjo tryezë të ketë sukses dhe partitë politike të bëjnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Zgjedhja e presidentit do të siguronte stabilitet politik edhe nëse vendi do të shkonte në zgjedhje të reja. Pra, nuk do të ishte e njëjta situatë sikurse vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues të detyrës së presidentit”, ka deklaruar Tahiri. Edhe deputeti i LDK-së, Fatmir Rexhepi, ka deklaruar se partitë politike do të duhej të gjenin një konsensus dhe ta zgjidhnin presidentin e ri para shkuarjes në zgjedhje. “Mendoj se të gjitha partitë politike parlamentare duhet të ulen dhe të arrijnë një marrëveshje politike për zgjedhjen e presidentit. Duhet ta ndajmë çështjen e presidentit prej qeverisë. Çështja e presidentit nuk duhet të përzihet me çështje të tjera sepse kjo do të na riciklojë sërish

Hoti: Nëse s'ka gatishmëri për zgjedhje të presidentit, të pajtohemi për datën e zgjedhjeve

Kryeministri i Kosovës dhe nënkryetari i LDK-së, Avdullah Hoti, nuk ka dhënë ndonjë datë se kur do të mbahet tryeza e partive politike për çështjen e presidentit. Ai ka thënë se me këtë çështje është duke u marrë kryetari i LDK-së, Isa Mustafa.

Hoti ka theksuar se nëse nuk ka gatishmëri për zgjedhjen e presidentit, partitë politike duhet të merren vesh për datën e zgjedhjeve parlamentare. “Unë pres që sa më parë të

organizohet tryeza e partive politike, për ta parë gatishmërinë e partive politike për të gjetur një zgjidhje për presidentin e vendit. Nëse ka gatishmëri tek pastaj ne duhet të ulemi dhe të bisedojmë cilën qasje duhet të ndjekim. Ne kemi dëgjuar në media që janë dhënë propozime të ndryshme nga disa prej partive politike, por ne duhet të ulemi në tryezë të partive politike parlamentare për ta bërë pyetjen elementare. Ka gatishmëri për të gjetur

zgjidhje për president, nëse ka do t'i caktojmë kriteret dhe qasjen për të dalë tek emri konkret i presidentit. E nëse nuk ka gatishmëri, duhet të merremi vesh për datën e zgjedhjeve”, ka thënë Hoti pas vizitës në Komitetin Olimpik të Kosovës. I pyetur se kur mund të organizohet ky takim, Hoti ka thënë se po bëjnë përpjekje që të realizohet sa më shpejtë. “Kryetari Mustafa është duke u marrë me këtë çështje”, është shprehur Hoti.

krizën për presidentin. Ftoj liderët e të gjitha partive që të ulen dhe ta bëjnë një kompromis për pozitën e presidentit. Të gjithë e kanë për borxh që ta gjejnë një presidenti

konsensual”, ka thënë Rexhepi për gazetën “Epoka e re”. Partnerët e koalicionit kanë më pak se pesë muaj kohë për arritjen e pajtimit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, post

ky që u bë pjesë e kalkulimeve politike pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi i cili dha dorëheqje më 5 nëntor.

Kosova regjistron edhe 11 viktima dhe 561 raste të reja me koronavirus



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë regjistruar 11 raste të vdekjes nga Covid-19. Sipas IKShPK-së, gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 884 pacientë dhe janë regjistruar 561 raste të reja të infektimit. “Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR, janë

testuar gjithsej 1357 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 561 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 11 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Gjilan 3 raste (72, 67, 62 vjeç), Gjakovë 2 raste (64, 51 vjeç), Prishtinë 1 rast (66 vjeç), Rahovec 1 rast (77 vjeç), Pejë 1 rast (63 vjeç), Prizren 1 rast (47 vjeç),

Suharekë 1 rast (75 vjeç), Obiliq 1 rast (78 vjeç)”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Instituti ka treguar se deri më tani numri i rasteve aktive është 12 253. “Numri total i rasteve pozitive është 44 442 raste nga 156 982 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 1 148 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 884 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve

deri më sot është gjithsej 31 041 raste, kurse numri i rasteve aktive është 12 253”, është thënë në njoftimin e IKShPK-së, duke evidentuar rastet e infektiveve nëpër komuna. “Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 269 raste, Podujevë 54 raste, Ferizaj 32 raste, Mitrovicë 30 raste, Fushë-Kosovë 20 raste, Gjilan 20 raste, Lipjan 20 raste, Viti 20 raste, Vushtrri 16 raste, Drenas 15 raste, Kamenicë 11 raste,

Malishevë 9 raste, Shtime 8 raste, Suharekë 6 raste, Istog 5 raste, Obiliq 5 raste, Prizren 5 raste, Skenderaj 5 raste, Graçanicë 4 raste, Novobërdë 3 raste, Kaçanik 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Gjakovë dhe Klllokot”, ka treguar instituti.

IKShPK-ja ka ftuar qytetarët që të vazhdojnë t'i respektojnë masat anti-Covid, të mbajnë distancë, të mbajnë maskë dhe t'i pastrojnë duart.

Historiani francez Serzh Mete (Serge Métais) reagon kundër Gjykatës Speciale

Historiani francez Serge Métais ka reaguar kundër Gjykatës Speciale me dy shkrime, në të cilat thekson se Gjykata Speciale është prodhim i një mashtrimi. Métais në pjesën e parë të

shkrimit shpjegon arsyet që kanë çuar në themelimin e Gjykatës Speciale, pra se si mbërritëm deri në këtë pikë. Historiani francez në pjesën e dytë të shkrimit flet për dobbinë e Gjykatës Speciale dhe

mbylljen e saj. Në pyetjen e tij: Çfarë duhet bërë? "Një hap i parë do të ishte një rezolutë e votuar nga Kuvendi i Kosovës me kërkesën për mbyllje të Gjykatës së Posaçme dhe rilokalizim të

procesit në Prishtinë. Ky do të ishte një sinjal i fuqishëm alarmi... në pritje të një projektligji i cili do ta zhbënte atë që ka bërë ligji i vitit 2015 dhe do t'i organizonte modalitetet e transferimit të

dosjes së akuzës në Kosovë", thekson autori në këtë shkrim. Këtu mund t'i shihni të dyja pjesët e shkrimit të historianit francez, Serge Métais, në gjuhën shqipe dhe gjuhën frënge për Gjykatën Speciale:



Serge Métais, Kosovë: Tribunali special, produkt i një mashtrimi (1)

Serge MÉTAIS

Gjykata e Posaçme për Kosovën e bëri publike aktakuzën e saj më 4 nëntor. Hashim Thaçi (presidenti kosovar, të cilit iu desh të jepte dorëheqjen) dhe tre ish-udhëheqës të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) akuzohen tani për "krime lufte" dhe për "krime kundër njerëzimit". Ata ndodhen të burgosur në Hagë.

Gjykata e Posaçme për Kosovën, e krijuar më 2015 është, në fakt, krijesë e një operacioni dezinformimi nga më të suksesshmit që prej shembjes së

regjimeve komuniste. Udhëheqësve të Bashkimit Evropian ajo u ka mbetur sot në dorë.

A mund ta lënë ata vallë këtë proces të vazhdojë duke bërë sikur të mos ketë ndodhur asgjë? Përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, është mirë t'i kthehemi edhe një herë natyrës së këtij procesi që ka çuar në ngritjen e Gjykatës së Posaçme, dmth si mbërritëm deri në këtë pikë.

Dezinformimi, një armë lufte

Për të kuptuar, duhet të rikujtojmë fillimisht se shërbimet

e fshehta jugosllave kanë qenë të organizuara sipas modelit sovjetik. Ashtu si KGB-ja, edhe UDB-ja (Sigurimi i Shtetit jugosllav) ishte një polici politike. Pra këto shërbime nuk ishin vetëm organe shtypjeje dhe censure; ato ishin gjithashtu të ngarkuara për të shkruar apo rishkruar ngjarje, për t'u përcjellë dosje drejtuesve të mediave duke orientuar ata se si ishte më e udhës të interpretoheshin apo të paraqiteshin ngjarje të caktuara. Ato kishin gjithashtu mundësi të kurdisnin operacione-kurthe, të shkaktonin "histori" me qëllimin për të ndikuar mbi opinionin publik. Le të përmendim vetëm dy

shembuj, sa për ta ilustruar këtë praktikë gjatë luftës së Kosovës. E para është çështja e "krematoriumit", në gusht 1998: ushtria dhe forcat serbe të sigurisë sapo i kishin rimarrë UÇK-së lokalitetin e Kleçkës dhe, me atë rast, siç e donte puna, zbuluan aty një furrë gëlqereje nga e cila u nxorën disa eshtra dhe mbetje njerëzore të padjegura plotësisht. Dy të rinj shqiptarë, vëllezërit Mazreku, të paraqitur si "ushtarë të UÇK-së", u arrestuan dhe "pranuan" që, së bashku me disa ushtarë të tjerë, kishin vënë në radhë disa dhjetëra serbë dhe i kishin pushkatuar. Trupat qenkëshin hedhur pastaj në furrë

dhe duhej të zhdukeshin në gëlqeren e pashuar... Paskësh pasur, sipas komunikatës zyrtare, "22 civilë serbë të vrarë e të djegur në krematoriumin e gëlqeres". Vioji më pas një shfaqje mediatike e padëgjuar ndonjëherë, me praninë në terren të një hetueseje, në "lidhje të drejtpërdrejtë" në televizionin kombëtar serb dhe me paraqitjen e dy të rinjve "terroristë", me pamje të shushatur, të cilët lëshonin fjali konfuzë para mikrofonave dhe kamerave. Më vonë do të mësohej se vëllezërit Mazreku ishin arrestuar më 30 korrik 1998, domethënë njëzeteshtatë ditë përpara asaj

shfaqje të zbulimit të "krimit" të tyre. Pasi u burgosën në Serbi, ata dolën më në fund të pafajshëm, asgjë e atillë nuk kishte ndodhur dhe ata u liruan në mars 2002. E gjitha ishte një trillim, më pas rezultoi se ishin drogë kur u nxorën para kamerave.

Shembulli tjetër është sulmi me armë nga njerëz me maska e të veshur me të zeza, në mbrëmjen e 14 dhjetorit 1998, në kafenenë Panda të Pejës, në Kosovë. Aty gjendeshin 13 të rinj serbë të ulur nëpër tryeza. U numëruan gjashtë të vrarë e tre të plagosur rëndë.

Ngjarja ngjalli emocion të pamasë në Serbi dhe mes komunitetit serb në Kosovë. Disa terroristë kishin bërë një kasaphanë në një kafene të frekuentuar nga të rinj serbë! Mbi njëqind të dyshuar u arrestuan fët e fët dhe u nënshtruan marrjeve në pyetje. Gjashtë të rinj shqiptarë "e pohuan" anëtarësinë e tyre në UÇK dhe pjesëmarrjen në atë krim.

Mirëpo, si përfundim, në mbarim të vitit 1999, ata u shpallën jo fajtorë dhe u liruan. Masakra e kafenesë Panda kishte qenë vepra e shërbimeve serbe të sigurimit. Aleksandar Vučić, sot president i Serbisë, asokohe zëvendëskryeministër, e pranoi publikisht këtë gjë gjatë një emisioni televiziv në fund të vitit 2013. Duke përmendur "vrasjen e gjashtë të rinjve serbë në kafenenë Panda më 1998", ai deklaroi: "Nuk ka elemente që të provojnë që ai krim të jetë kryer nga shqiptarë ashtu siç mendonim ne".

Çështje të tilla si ato të "krematoriumit" e të kafenesë Panda kishin si qëllim që të ndreqnin disa "mangësi" për opinionin publik serb. Vërtet që luftëtarët shqiptarë mund të denoncohenin si "terroristë", mirëpo nevojitej edhe ca më shumë për ta prekur ndjeshmërinë e njerëzve. UÇK-ja ngrinte prita. Objektivat e saj ishin, në radhë të parë, policë, ushtarakë e paraushtarakë. Shqiptarët nuk e ushtronin terrorizmin e verbër që prek popullsinë civile. Nuk bënin asgjë që të mund ta trondiste opinionin publik në Serbi e ta rreshtonin atë përkrah pushtetit, siç mund të ishin atentatet e neveritshme symbyllas apo krimet barbare!

Çështja e trafiqeve të organeve është pjesë e të njëjtit avaz. Ajo është kurdisur më vonë, pas luftës, në fillim të viteve 2000. UÇK-ja u akuzua për ushtrim heqjeje organesh mbi robër serbë, në Shqipëri, në afërsi të Burrelit, në një "shtëpi të verdhë". Ato organe paskëshin qenë për "eksport", përmes aeroportit të Tiranës. Paskësh pasur qindra viktimë. Krimi ishte i përbindshëm.

Nuk dihet fort mirë se në cilin moment na qenkësh kryer. Mos vallë pas bombardimeve të NATO-s gjatë pranverës 1999, ndërkohë që në Kosovë po vendosej Misioni i Kombeve të

Bashkuara? Na duhet të besojmë, gjithsesi, se ajo dosje ishte mjaftueshëm bindëse sa që prokurorja e GJPNJ-së (Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë), Carla del Ponte, ta merrte seriozisht dhe të urdhëronte një hetim në terren, në Shqipëri, më 2004. Ku nuk gjeti asgjë.

Mirëpo, pas largimit të saj nga Gjykata, ajo iu kthye sërish asaj çështjeje në kujtimet e veta të botuara më 2006, a thua se ishte fjala për një dosje pezull, e cila nuk qenkësh trajtuar me vëmendjen e merituar. Kaq mjaftonte që mekanizmi djallëzor të vihej sërish në lëvizje. Le të shkruante sa të donte Florence Hartmann, ish-zëdhënëse e prokurores (dhe ish-gazetare e *Le Monde*), se Carla del Ponte po ngrinte akuza "pa pasur as elementin më të vogël të ndonjë prove".

Bernard Kouchner, ish-kreu i UNMIK-ut (Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë), e kuptoi më së miri se ku flinte lepuri. I pyetur nga një gazetar serb, në vitin 2010, gjatë një vizite në Kosovë, ai u përgjigj se ata që e kanë lëshuar këtë akuzë për trafik organesh të marra nga robër serbë "janë maskarenj dhe vrasës".

Rrethanat, në vitet 2008-2010, ishin në fakt të volitshme për suksesin e atij kurthi. Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj. Rusët dhe serbët ishin tërbuar dhe shumë vende evropiane ngurrnin, duke mos qenë fort të sigurt për rrugën që duhej të ndiqnin lidhur me njohjen e pavarësisë së Kosovës. Edhe sot e kësaj dite, për arsye që, siç mund të merret me mend, kanë të bëjnë me politikën e brendshme, një vend si Spanja nuk e njeht këtë pavarësi.

Ofensiva u ndërmoi, që në prill 2008, në Këshillin e Evropës. Rusët aty e shohin veten shpeshherë të bërë leckë për çështje që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut në vendin e tyre. Ata do të kishin një rast për ta përmbysur situatën. Një deputete ruse paraqiti një projektzotim për hetim mbi një "trafik të paligjshëm organesh njerëzore në Kosovë".

Pastaj erdhi, në fund të vitit 2010, raporti Dick Marty, të quajtur kështu sipas emrit të një anëtari të Dhomës së Lartë të Parlamentit zviceran, të zgjedhur si "liberal-radikal" nga kantoni i Tiçinos, ish-prokuror, anëtar i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

Dick Marty është një nga ata që, në traditën leniniste, i quajnë "idiot i dobishëm". Ai nuk ndan të njëjtin vizion me Partinë, madje qëndron, objektivist, në anën e armikut. Mirëpo, për arsye të pazbulueshme (anti-amerikanizëm? ego? nevojë për t'u bërë i njohur në botë?), ai është i gatshëm që të bëhet zëdhënësi i çfarëdo kauze që Partia e ka për zemër.

Për të, gjithçka filloi në vitin 2006

me një raport që paraqiti, para Këshillit të Evropës, rreth burgjeve sekrete të CIA-s në Evropë (në të cilat u mbajtëshin xhihadistë). Është e lehtë të merren me mend intensiteti i punës hetimore që iu desh të bënte një parlamentari zviceran për një temë aq delikate, si edhe burimi i informacioneve të tij. Këshilli i Evropës i besoi atij më pas një mision informimi rreth situatës në Çeçeni, në Ingushi e në Dagestan. Raporti për atë çështje, në vitin 2009, i dha atij mundësi që t'i falënderonte krerët e Sigurimit dhe të Drejtësisë të atyre republikave të Federatës Ruse ku ai mundi ta kryente hetimin e vet në frymën më të mirë të bashkëpunimit, ndonëse pohonte, nga halli për t'u treguar i pavarur, se "situata e pandëshkueshmërisë pothuaj të plotë për krimet e kryera prej përfaqësuesve të forcave të rendit në kuadër të operacioneve antiterroriste duket se vazhdon". Me raportin Marty, kati i fundit i raketës së operacionit të dezinformimit ishte gati. Ndërkohë, siç e lypte puna, në vitin 2008, në Kosovë u zbulua një trafik i përnjëmendtë organesh: në klinikën "Medicus" në Prishtinë merreshin veshka nga dhurues, disa prej të cilëve vinin posaçërisht nga jashtë shtetit, kundrejt shpërbllimit. A mos ishte vallë ky një kurth ku ranë disa kirurgë shqiptarë të joshur nga fitimi? Veshkat u tha se u ishin riimplantuar disa pacientëve jashtë shtetit. Çështja "Medicus" i sillte në dukje një vërtetësi të jashtëzakonshme akuzës për trafik organesh të kryer nga UÇK-ja disa vite më parë. Ajo u shfrytëzua në mënyrën më të përshtatshme nga Dick Marty në raportin e tij "Trajtim çnjerëzor personash dhe trafik i paligjshëm organesh njerëzore në Kosovë".

Pikërisht mbi bazën e atij raporti, të miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, u vendos krijimi i këtij institucioni shumë original që quhet Gjykata e Posaçme. Meqenëse gjykatat e Kosovës konsideroheshin si të paafte për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, u ra dakord për një krijesë hibride, gjysmë

kosovare, gjysmë ndërkombëtare, një strukturë *ad hoc* e quajtur "Dhomat e Posaçme dhe Zyra e Prokurorit të Posaçëm". Duke qenë e emërtuar kështu, origjinaliteti i kësaj gjykate është se ajo duhet të gjykojë sipas legjislacionit të Kosovës, por selinë e ka në Hagë. Ajo financohet nga Bashkimi Evropian. Ndonëse është tërësisht e përfshirë në sistemin gjyqësor kosovar, personeli i saj (gjyqtarët dhe prokurori) përbëhet nga shtetas të Bashkimit Evropian, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Kanadasë. Tanimë e dimë që asaj nuk do t'i duhet të gjykojë rreth çfarë ka qenë themeli i krijimit të saj: trafikut të pretenduar të organeve. Por prapëseprapë ai kurth ka pasur sukses të plotë. Qëllimi i synuar nuk ka qenë dënimi mbi bazë provash të rreme. Suksesi qëndron te gjurma që do të lërë gënjeshtra: "Shpif, shpif, se përherë do të mbetet diçka!". Dhe në "patatën përvëluese", sot në duart e udhëheqësve të Bashkimit Evropian: Gjykata e Posaçme për Kosovën.

Të mos i vuajmë më pasojat e mashtrimit të madh

Nevojitet urgjentisht që Bashkimi Evropian ta marrë vetë rolin udhëheqës lidhur me dosjen Serbi-Kosovë. Në vitet 1998-1999, i përçarë dhe i paafte për t'i ndalur ato akte dhune që regjimi i Milosheviçit kryente në Kosovë, ai vetëm sa ndoqi vendimin amerikan. Më pas, ai e la veten të mashtrohej nga ky manipulim i shërbimeve të fshehta serbe dhe ruse, i cili çoi në krijimin e Gjykatës së Posaçme. Dhe nuk ka qenë në Evropë, por në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nën mburojë të Donald Trump-it, vendi ku janë mbajtur negociatat e fundit ndërmjet serbëve dhe kosovarëve për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre. Serbia dhe Kosova janë dy shtete evropiane që kanë prirje për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian. Ato janë sot vende demokratike. Situata duhet të

qetësohet. Dhe të jepen perspektiva të reja.

Ndjenja e padrejtësisë që provojnë kosovarët është e skajshme. Sado që në përgjithësi janë të mendimit se lufta e tyre ishte e drejtë, ata nuk shprehen aspak njëzëri në gjykimin që kanë rreth mënyrës se si ajo është zhvilluar. Dhe nuk diskutohet që nga UÇK-ja janë kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit (në kuptimin që u jepet sot këtyre koncepteve). Mirëpo, qysh të gjykohej këto krime në një gjykatë ndërkombëtare pa u gjykuar njëherazi ato krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, mjaft të shumta në numër, masive dhe të mirëdokumentuara, të kryera në Kosovë nga forcat e sigurimit, ushtria dhe paraushtarakët serbë?

Një vendim i arsyeshëm do të ishte që të mbyllen me shpejtësi Dhomat e Posaçme dhe Zyra e Prokurorit të Posaçëm dhe dosja e akuzës të transferohet në Kosovë. Përderisa këto institucione përfshihen në sistemin gjyqësor kosovar, procesi thjesht do të delokalizohet. E thënë ndryshe, në qoftë se më parë konsiderohej që ai ishte delokalizuuar në Hagë, tani ai do të rilokalizohet në Kosovë.

Vetëkuptohet që personat e vënë nën akuzë do të liroheshin menjëherë dhe do të paraqiteshin të lirë para gjykatës.

Shqipëroi Arben LESKAJ

Autori Serge Métais mban gradën doktor i shkencave ekonomike dhe ka qenë profesor në Universitetin e Menit, në Le Mans të Francës. Ai është bërë i njohur me artikuj të shumtë kushtuar, në veçanti, krizës polake dhe përpjekjeve për reformë në Bashkimin Sovjetik të kohës së Gorbaçovit. Përveç veprave të shkruara në fushën e ekonomisë, si *Metoda sasiore të zbatuara në menaxhim* (1993), ai është edhe autor i librit *Histoire des Albanais. Des Illyriens à l'indépendance du Kosovo* (Histori e shqiptarëve. Nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës) të botuar në Francë më 2006 nga shtëpia botuese Fayard e të përkthyer edhe në shqip e në bullgarisht.



Kosovo: le Tribunal spécial, produit d'une imposture (1)

Serge MÉTAIS

Le Tribunal spécial pour le Kosovo a rendu public son acte d'accusation le 4 novembre. Hashim Thaçi (le président kosovar qui a dû démissionner) et trois autres anciens dirigeants de l'Armée de Libération du Kosovo (UÇK, en albanais) sont maintenant inculpés de « crimes de guerre » et de « crimes contre l'humanité ». Ils sont incarcérés à La Haye.

Ils sont tenus responsables de crimes qui auraient été commis entre mars 1998 et septembre 1999, sur des lieux où l'UÇK aurait détenu des prisonniers. L'accusation en répertorie une quinzaine au Kosovo, parmi lesquels des postes de police dont elle avait pris le contrôle, et deux dans le nord de l'Albanie. Mais le plus important, c'est qu'on ne trouve rien dans l'acte d'accusation sur de prétendus

trafics d'organes prélevés sur des prisonniers serbes. L'enquête n'a rien pu retenir pour fonder une accusation. Nous avons ainsi la confirmation que les allégations portant sur des trafics d'organes sont bien une infamie montée par les services secrets serbes et russes.

Cela pose le problème de la légitimité du Tribunal spécial pour le Kosovo, créé en 2015. Il est, en fait, le produit d'une opération de désinformation parmi les plus abouties depuis l'effondrement des régimes communistes. Les dirigeants de l'Union européenne l'ont aujourd'hui sur les bras. Peuvent-ils laisser le procès se poursuivre comme si de rien n'était ?

Mais, avant de répondre à cette question, il convient de revenir sur la nature de l'opération de désinformation qui a conduit à la création du Tribunal spécial. Comment en est-on arrivé là ?


La désinformation, une arme de guerre

Pour comprendre, il faut, tout d'abord, rappeler que les services secrets yougoslaves étaient organisés sur le modèle soviétique. Comme le KGB, l'UDB (la Sécurité d'Etat yougoslave) était une police politique. Ces services n'étaient pas seulement des organes de répression et de censure. Ils étaient aussi chargés d'écrire ou de réécrire l'histoire, de fournir des fiches aux responsables des médias (désignés comme « organes d'information de masse ») leur disant comment il convenait d'interpréter ou de présenter certaines actualités. Ils pouvaient aussi monter des opérations ou coups tordus, créer des « événements » destinés à former l'opinion publique. Nous n'évoquons que deux exemples pour illustrer cette pratique durant la guerre du Kosovo. Le premier est l'affaire

du « four crématoire », en août 1998 : l'armée et les forces de sécurité serbes venaient de reprendre la localité de Kleçkë à l'UÇK ; on y découvrit alors opportunément un four à chaux duquel furent extraits des ossements et des restes humains non calcinés. Deux jeunes Albanais, les frères Mazreku, présentés comme des « soldats de l'UÇK » furent arrêtés et « reconnurent » qu'avec d'autres soldats ils avaient aligné des dizaines de Serbes et les avaient fusillés. Les corps auraient ensuite été jetés dans le four et devaient disparaître dans la chaux vive... Il y aurait eu, selon le communiqué officiel, « 22 civils serbes tués et brûlés dans le crématorium à chaux ». Un spectacle médiatique inouï s'ensuivit avec la présence sur le terrain d'une juge d'instruction, des « directs » à la télévision nationale serbe et la présentation des deux jeunes « terroristes », l'air hébété, tenant des propos confus devant

les micros et les caméras. On apprendra plus tard que les frères Mazreku avaient été arrêtés le 30 juillet 1998, c'est-à-dire vingt-sept jours avant le spectacle de la révélation de leur « crime ». De toute évidence, ils étaient drogués lorsqu'ils parlaient devant les caméras. Condamnés, emprisonnés en Serbie, ils furent finalement reconnus innocents et libérés en mars 2002.

L'autre exemple est la fusillade par des hommes masqués, habillés en noir, le soir du 14 décembre 1998, dans le café Panda à Pejë, au Kosovo. 13 jeunes Serbes y étaient attablés. On dénombra six morts et trois blessés graves. L'émotion fut immense en Serbie et dans la communauté serbe du Kosovo. Des terroristes avaient fait un carnage dans un café fréquenté par des jeunes Serbes ! Plus d'une centaine de suspects furent bientôt arrêtés et soumis à des interrogatoires. Six jeunes Albanais « avouèrent »



Kosovë. Cila është dobia e një gjykate të posaçme dhe a ia vlen të hiqet qafe? (2)



Nga Serge MÉTAIS*

Duhet ta pranojmë që gjykata e posaçme për Kosovën e tregoi dobinë e vet. Ajo dha mundësi për të vërtetuar se pretendimet lidhur me trafike organesh janë përnjëmend një batakçillëk. Dhe vërtet, tek aktakuza¹ as që bëhet fare fjalë për trafike të pretenduara organesh të marra nga robër serbë. Hetimi nuk ka zbuluar dot asgjë ku të mund të mbështetej një akuzë për krime aq të turpshme.

Mirëpo, vetëm me kaq mbaron dobia e këtij juridiksioni të posaçëm të ngritur në vitin 2015 mbi bazë ligjesh të votuara nga Parlamenti i Kosovës. Dhe kjo, nën trysninë miqësore euroatlantike. Tani, ai është i papërligjur. Siç e kemi përmendur tashmë, do të ishte e udhës që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Posaçëm të mbyllen dhe dosja e akuzës të transferohet në Kosovë. Procesi do të mund të vazhdohej aty. I delokalizuar në Hagë për arsye të cilat nuk qëndrojnë më, ai do të mund të rilokalizohet në Kosovë.

Le ta marrin tani në shqyrtim këtë propozim! Duhet ta saktësojmë që nuk është fjala as për të mbyllur një gjykatë penale ndërkombëtare, as për të ndërprerë një procedurë gjyqësore.

Gjykata e Posaçme është një institucion i Kosovës

Gjykata e Posaçme për Kosovën (Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Posaçëm) nuk është një gjykatë penale ndërkombëtare. Ajo nuk është as Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjPNJ), as ndonjë juridiksion i posaçëm që rrjedh nga kjo e fundit. GjPNJ-ja u krijua më 25 maj 1993 përmes Rezolutës 827 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe u shkri më 31 dhjetor 2017. Misionet e saj mbeturinore iu transferuan një institucioni të quajtur "Mekanizmi mbeturinor për Gjykatat Penale Ndërkombëtare", i cili nuk ka të bëjë aspak me Gjykatën e Posaçme për Kosovën. Gjykata e Posaçme për Kosovën

nuk është aspak ndonjë juridiksion i posaçëm i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GjPN). Vendndodhja e saj në Hagë, njëlloj si GjPN-ja, nuk nënkupton kurrfarë varësie.

Gjykata Penale Ndërkombëtare është sot i vetmi juridiksion penal ndërkombëtar i përhershëm dhe me prirje të përbotshme. Ajo është e ngarkuar të gjykojë personat e akuzuar për krime lufte, krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. GjPN-ja është e themeluar mbi bazën e një traktati ndërkombëtar të quajtur "Statuti i Romës", të hyrë në fuqi më 2002, pas ratifikimit të tij nga 60 shtete. GjPN-ja nuk mund t'i trajtojë pretendimet për trafik organesh që paskësh ndodhur diku rreth verës së vitit 1999, sepse kompetencat e saj nuk janë prapavepruese.

Për ta kuptuar se çfarë është, në realitet, Gjykata e Posaçme për Kosovën, duhet të kthehemi te rrethanat pas miratimit të raportit Marty. Emocioni që ngjalli ai raport, i votuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, në fillim të vitit 2011, ishte shumë i fuqishëm. Ai u miratua nga 169 përfaqësues të shteteve anëtare. Pati vetëm 8 vota kundër dhe 14 abstenime. Të njëmbëdhjetë francezët, nga të gjitha kahet politike, votuan në favor. Të gjithë gjermanët, të gjithë belgët, të gjithë holandezët, etj., votuan në favor. Është për të ardhur keq për atë farë syleshtësie, mungese mprehtësie apo thjesht maturie kritike të përfaqësuesve tanë përballë atij manipulimi të ndyrë. Por ky ishte një realitet që, me hir a me pahir, duhej pranuar. Pikërisht, mbi bazën e pretendimeve të raportit Marty, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosën, në shtator 2011, të krijonin një "Grup të Posaçëm Hetimor" (*Special Investigative Task Force*). Për drejtimin e tij, u ra dakord të caktohej një prokuror amerikan, Clint Williamson.

Parlamenti i Kosovës miratoi, në maj 2012, një ligj për bashkëpunimin me këtë *Task Force*, çka i dha mundësi kësaj të fundit të kryente një hetim penal të pavarur rreth pretendimeve që përmbante raporti Marty. Madje, për të përforsuar pavarësinë dhe anën konfidenciale të këtij procesi, Grupi i Posaçëm Hetimor përbëhej ekskluzivisht nga një personel evropian dhe amerikan. Më 29 korrik 2014, pas më shumë se dy vjet hetimi, prokurori Williamson, gjatë një konference

për shtyp në Bruksel, deklaroi që trafiku i organeve nuk mund të vërtetohej veçse në "më pak se dhjetë raste". Ai shtoi: "Të ekzagjerohen shifrat ose të thuhet se çdo serb i vrarë apo i shpallur i humbur është bërë objekt i ndonjë heqjeje organesh nuk i shërben kurrfarë interesi, por vetëm sa shton dëshpërimin e familjeve të personave të humbur, sepse nuk ka asnjë provë të vetme".

Si nata me ditën në krahasim me ato qindra raste që sugjeronte raporti Marty! Dhe, domethënia e fjalëve "më pak se dhjetë" mund të ishte "zero". Mirëpo ishte vështirë të ndalej mekanizmi djallëzor. Mbi bazën e elementeve hetimore të *Task Force-s* dhe trysnisë së ushtruar nga Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, Parlamenti i Kosovës u detyrua të miratonte nenin 162 të Kushtetutës së saj, si edhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Posaçëm (Ligjin nr. 05/L-053). Kështu, në vitin 2015, Gjykata e Posaçme për Kosovën zuri vendin e *Task Force-s*, e cila i dha fund veprimtarisë së saj.

Kjo gjykatë konsiderohet si me natyrë të përkohshme. Mandati dhe kompetenca e saj janë specifike. Dhomat e Specializuara janë të lidhura, në çdo nivel, me sistemin gjyqësor të Kosovës: Gjykatën e Shkallës së Parë, Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. Ato funksionojnë në përputhje me ligjet e Kosovës. Zyra e Prokurorit të Posaçëm, e ngarkuar për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që i përkasin kompetencës së Dhomave të Specializuara, është e pavarur. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Posaçëm i jep mundësi këtij të fundit të kërkojë, ndër të tjera, praninë dhe marrjen në pyetje të personave të dyshuar, të viktimave dhe të dëshmitarëve, të mbledhë e të shqyrtojë informata dhe elemente provash, si edhe të marrë vendime për ndjekjen ose për mbylljen e procedurave penale. Zyra e Prokurorit të Posaçëm vepron në mënyrë të pavarur nga Dhomat e Specializuara dhe nga të gjithë prokurorët e tjerë të Kosovës. Është pikërisht kjo Zyrë, e drejtuar sot nga prokurori amerikan Jack Smith, ajo që e ka paraqitur aktakuzën e bërë publike më 4 nëntor.

Tani e dimë që domethënia e fjalëve "më pak se dhjetë" është

përnjëmend "zero": aktakuza nuk përmban absolutisht asgjë rreth pretendimeve për trafik organesh. Është vërtetuar plotësisht tashmë që bashkësia euroatlantike, dhe sidomos Bashkimi Evropian, është mashtruar keqas nga një prej operacioneve më të suksesshme të dezinformimit që prej shembjes së regjimeve komuniste. Mbyllja e Gjykatës së Posaçme për Kosovën nuk ka pse mos të jetë një sanksion normal ndaj tij. Parlamenti i Kosovës mund të marrë vetë vendim për këtë. Përderisa është vetë ai që e ka bërë ligjin për krijimin e kësaj gjykate, ai edhe mund ta zhbëjë atë.

Por gjërat nuk janë aq të thjeshta. Është bërë një punë e madhe hetimore. Nuk ka sesi të vihen në dyshim serioziteti dhe përpikëria e saj. Ekziston një aktakuzë disi boll e rëndë. Procedura gjyqësore nuk mund të ndalet. Ajo duhet të çohet deri në fund.

Të rilokalizohet procedura gjyqësore në Kosovë

Krijimi i Gjykatës së Posaçme, të delokalizuar në Hagë, me personel evropian dhe amerikanoverior, përligjej për dy arsye thelbësore: karakteri veçanërisht i urryer i krimeve të pretenduara (trafik organesh të marra nga robër serbë) dhe mbrojtja e dëshmitarëve.

Tani e dimë që ajo nuk do të ketë për të gjykuar për pretendime trafik organesh. Ajo për çka do t'i duhet të gjykojë, ajo çka përmban aktakuza, është me një natyrë tjetër. Krimet e pretenduara janë keqtrajtime robërisht, akte torture, ekzekutime pa gjyq, vrasje "tradhtarësh", "bashkëpunëtorësh të armikut" apo thjesht kundërshtarësh politikë të hamendësuar. Këtu nuk është fjala për t'i vënë këto vepra në diskutim apo për t'i renditur sipas ndonjë shkalle serioziteti në krahasim me trafikun e organeve të marra nga robër. Edhe aq, ato mund të cilësohen njëlloj si "krime lufte" ose "krime kundër njerëzimit". Thjesht, ato krime janë të tjera. Dhe pikërisht për këtë arsye, ato nuk ka përse të gjykohen në Hagë. Procesi mund të rilokalizohet në Kosovë.

Në fakt, gjithçka që përmban aktakuza e tanishme është e njohur dhe e dokumentuar mirë, pas më shumë se njëzet vjetësh që prej përfundimit të luftës. Shumë prej krimeve të pretenduara janë gjykuar tashmë në kuadër të

juridiksioneve të tjera: GjPNJ-së ose gjykatave të Kosovës, në kohën e UNMIK-ut (Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara) e pastaj të EULEX-it (Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit). E reja është që, kësaj radhe, të akuzuarit nuk janë më komandantë vendorë, aktorë të drejtpërdrejtë të krimeve të kryera. Tanimë janë udhëheqësit më të lartë të UÇK-së ata që po akuzohen se i paskan urdhëruar ose mbuluar krimet. I takon Drejtësisë kosovare, në Kosovë, të gjykojë rreth fajësisë së tyre.

Mbyllja e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Posaçëm nuk mund të merret në konsideratë pa i përkufizuar më parë me saktësi modalitetet e transferimit të dosjes së akuzës në Kosovë. E mira është që të lidhet një marrëveshje ndërmjet qeverisë së Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në anën tjetër. Mirëpo problemi është se nismën për një gjë të tillë nuk do ta marrin as udhëheqësit evropianë, as ata amerikanë. Ata janë të zënë me boll halle të tjera. Procesi i parashikuar në Hagë ka mundësi të mos fillojë përpara vitit 2022. Ai mund të zvarritet pa fund. Askush nuk do të bëhej merak. Asgjë nuk do të lëvizë, në të vërtetë, për aq kohë sa të mos ketë trysni nga ana e Kosovës.

Atëherë, çfarë duhet bërë? Një hap i parë do të ishte një rezolutë e votuar nga Parlamenti i Kosovës me kërkesën për mbyllje të Gjykatës së Posaçme dhe rilokalizim të procesit në Prishtinë. Ky do të ishte një sinjal i fuqishëm alarmi... në pritje të një projektligji i cili do ta zhbente atë që ka bërë ligji i vitit 2015 dhe do t'i organizonte modalitetet e transferimit të dosjes së akuzës në Kosovë.

Shqipëroi Arben LESKAJ

*) Autor i librit *Histoire des Albanais. Des Illyriens à l'indépendance du Kosovo* (Histori e shqiptarëve. Nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës) të botuar në Francë më 2006 nga shtëpia botuese Fayard e të përkthyer edhe në shqip e në bullgarisht.

¹ Aktakuza kundër Hashim Thaçit dhe tre ish-udhëheqësve të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është bërë publike më 4 nëntor. Ajo mund të lexohet në sajtin "Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's Office". Shih çështjen me numër KSC-BC-2020-06.

Kosovo: de l'utilité de tribunal spécial et de s'en défaire (2)



Serge MÉTAIS,

Reconnaissons-le, le tribunal spécial pour le Kosovo a été utile. Il a permis de confirmer que les allégations portant sur des trafics d'organes sont bien une imposture. En effet, dans l'acte d'accusation^[1], on ne trouve rien sur de prétendus trafics d'organes prélevés sur des prisonniers serbes. L'enquête n'a rien pu retenir pour fonder une accusation sur des crimes aussi infamants.

Mais, là s'arrête l'utilité de cette juridiction spéciale mise en place en 2015 sur la base de lois votées par le Parlement du Kosovo. Cela, sous l'amical pression euro-atlantique. Elle est maintenant illégitime. Nous avons déjà évoqué l'idée selon laquelle il conviendrait de fermer les Chambres spécialisées et le Bureau du procureur spécial, et transférer le dossier d'accusation au Kosovo. Le procès pourrait s'y poursuivre. Délocalisé à La Haye pour des raisons qui ne tiennent plus, il serait relocalisé au Kosovo. Il convient d'examiner maintenant cette proposition. Nous devons préciser qu'il ne s'agit ni de fermer un Tribunal pénal international ni d'interrompre une procédure judiciaire.

Le Tribunal spécial est une institution du Kosovo

Le Tribunal spécial pour le Kosovo (les Chambres spécialisées et le Bureau du procureur spécial) n'est pas un Tribunal pénal international. Il n'est ni le Tribunal pénal international pour l'ex-Yougoslavie (TPIY) ni une juridiction spéciale émanant de ce dernier. Le TPIY a été créé le 25 mai 1993 par la résolution 827 du Conseil de sécurité de l'ONU. Il a été dissous le 31 décembre 2017. Ses missions résiduelles ont été transférées à une institution, appelée « Mécanisme résiduel pour les Tribunaux pénaux internationaux », qui n'a rien à voir avec le Tribunal spécial pour le Kosovo.

Le tribunal spécial pour le Kosovo n'est pas non plus une juridiction spéciale de la Cour Pénale Internationale (CPI). Sa localisation à La Haye, comme la CPI, ne signifie aucune dépendance.

La Cour pénale internationale est aujourd'hui

la seule juridiction pénale internationale permanente et à vocation universelle. Elle est chargée de juger les personnes accusées de crime de guerre, de crime contre l'humanité ou de génocide. La CPI a été fondée sur la base d'un traité international, appelé « Statut de Rome », entré en vigueur en 2002 après sa ratification par 60 États. Les allégations de trafic d'organes remontant à une période autour de l'été 1999, ne peuvent être traitées par la CPI, car sa compétence n'est pas retroactive. Pour comprendre ce qu'est, en réalité, le Tribunal spécial pour le Kosovo, il convient de revenir sur le contexte d'après l'approbation du rapport Marty. L'émotion suscitée par ce rapport, voté par l'Assemblée parlementaire du Conseil de l'Europe, début 2011, était très forte. Il fut approuvé par 169 représentants des États membres. Il n'y eut que 8 contre et 14 abstentions. Les onze Français, toutes tendances politiques confondues, ont voté pour. Tous les Allemands, tous les Belges, tous les Néerlandais, etc., ont voté pour. On peut se désoler d'autant de naïveté, d'absence d'esprit ou simplement de prudence critique de nos représentants face à ce qui était une manipulation abjecte. Mais c'était une réalité avec laquelle il fallait composer.

C'est, sur la base des allégations du rapport Marty, que l'Union européenne et les États-Unis décidèrent, en septembre 2011, de créer un « Groupe spécial d'enquête » (*Special Investigative Task Force*). Pour le diriger, on s'accorda pour désigner un procureur américain, Clint Williamson.

Le Parlement du Kosovo adopta une loi sur la coopération avec cette *Task force*, en mai 2012. Elle permit à cette dernière de mener une enquête criminelle indépendante sur les allégations contenues dans le rapport Marty. Et pour renforcer l'indépendance et l'aspect confidentiel du processus, le Groupe spécial d'enquête était composé exclusivement de

personnel européen et américain.

Le 29 juillet 2014, après plus de deux ans d'enquête, le procureur Williamson, lors d'une conférence de presse à Bruxelles, déclara que le trafic d'organes ne pourrait être confirmé que sur « moins de dix cas ». Il ajouta : « Exagérer les chiffres ou dire que chaque Serbe tué ou porté disparu a fait l'objet d'un prélèvement d'organes ne sert aucun intérêt, mais augmente la détresse des familles des disparus, car il n'y a aucune preuve ».

On était loin des centaines de cas suggérés dans le rapport Marty. Et, moins de dix pouvait signifier zéro. Mais il était difficile d'arrêter la machine infernale. Sur la base des éléments d'enquête de la *Task force* et de la pression exercée par l'Union européenne et les États-Unis, le Parlement du Kosovo fut conduit à adopter l'article 162 de sa Constitution et la Loi sur les Chambres spécialisées et le Bureau du Procureur spécial (Loi n° 05/L-053). C'est ainsi, qu'en 2015, le Tribunal spécial pour le Kosovo prit la place de la *Task force*. Laquelle mit alors fin à son activité.

Ce tribunal est considéré comme de nature temporaire. Il est doté d'un mandat et d'une compétence spécifiques. Les Chambres spécialisées sont rattachées, à chaque niveau, au système judiciaire du Kosovo : Tribunal de première instance, Cour d'appel, Cour suprême et Cour constitutionnelle. Elles fonctionnent conformément aux lois du Kosovo. Le Bureau du Procureur spécial, chargé d'enquêter et de poursuivre les crimes relevant de la compétence des Chambres spécialisées, est indépendant. La loi sur les Chambres spécialisées et le Bureau du Procureur spécial permet à ce dernier de demander, entre autres, la présence et l'interrogation de suspects, victimes et témoins, de recueillir et examiner des informations et des éléments de preuve, et de prendre des décisions sur la poursuite ou la clôture des procédures pénales. Le Bureau du Procureur spécial agit indépendamment des Chambres spécialisées et de tous les autres procureurs du Kosovo. C'est ce Bureau, dirigé aujourd'hui par le procureur

américain Jack Smith, qui a produit l'acte d'accusation rendu public le 4 novembre.

On sait maintenant que « moins de dix » signifie zéro : il n'y a absolument rien dans l'acte d'accusation sur des allégations de trafic d'organes. La démonstration est faite que la Communauté euro-atlantique, particulièrement l'Union européenne, a été abusée par une opération de désinformation parmi les plus abouties depuis l'effondrement des régimes communistes. La fermeture du Tribunal spécial pour le Kosovo devrait en être une sanction normale. Le Parlement du Kosovo peut en décider. Il a fait la loi créant ce tribunal, il peut la défaire.

Mais les choses ne sont pas si simples. Un travail d'enquête important a été fait. On ne saurait mettre en doute son sérieux et sa rigueur. Le dossier d'accusation est volumineux. On ne peut arrêter la procédure judiciaire. Elle doit être menée à son terme.

Relocaliser la procédure judiciaire au Kosovo

La création d'un Tribunal spécial, délocalisé à La Haye, avec un personnel européen et nord-américain, se justifiait pour deux raisons essentielles : le caractère particulièrement odieux des crimes allégués (le trafic d'organes prélevés sur des prisonniers serbes) et la protection des témoins.

Nous savons maintenant qu'il n'y aura pas à juger sur des allégations de trafic d'organes. Ce sur quoi il y aura à juger, ce que contient l'acte d'accusation, est d'une autre nature. Les crimes allégués sont des mauvais traitements subis par des prisonniers, des actes de tortures, des exécutions sans jugement, des meurtres de supposés « traîtres », « collaborateurs » ou simplement opposants politiques. Il n'est pas question de les discuter ni de les situer dans une échelle de gravité par rapport au trafic d'organes prélevés sur des prisonniers. Ils peuvent être également qualifiés de « crimes de guerre » ou de « crimes contre l'humanité ». Simplement, ces crimes sont autres. Et c'est ce qui fait qu'il n'y a pas lieu de les juger à La Haye. Le procès peut être relocalisé au Kosovo.

En fait, tout ce qui est contenu

dans l'acte d'accusation est bien connu et documenté, plus de vingt ans après la fin de la guerre. Nombre des crimes allégués ont déjà été jugés dans le cadre d'autres juridictions : le TPIY ou les tribunaux du Kosovo, au temps de la MINUK (Mission intérimaire des Nations-Unies) puis d'EULEX (Mission « Etat de droit » de l'Union Européenne). Ce qui est nouveau, c'est que les accusés ne sont plus, cette fois, des commandants locaux, des acteurs directs des crimes commis. Ce sont maintenant les plus hauts dirigeants de l'UÇK qui sont accusés d'avoir ordonné ou couvert les crimes. C'est à la Justice kosovare, au Kosovo, de juger de leur culpabilité.

La fermeture des Chambres spéciales et du Bureau du procureur spécial ne peut être considérée sans définir précisément les modalités du transfert du dossier d'accusation au Kosovo. Il est souhaitable qu'il y ait un accord entre le gouvernement du Kosovo, d'une part, l'Union européenne et les États-Unis, d'autre part. Mais le problème est que ni les dirigeants européens ni les dirigeants américains n'en prendront l'initiative. Ils ont bien d'autres préoccupations. Le procès prévu à la Haye pourrait ne pas commencer avant 2022. Il pourrait bien traîner en longueur. Cela ne gênerait personne. Rien ne bougera, en fait, tant que la pression ne viendra pas du Kosovo.

Alors que faire ? Une résolution votée par le Parlement du Kosovo demandant la fermeture du Tribunal spécial et la relocalisation du procès à Pristina serait une première alerte. Un premier signal fort... en attendant un projet de loi qui déferait ce qu'a fait la loi de 2015 et organiserait les modalités du transfert du dossier d'accusation au Kosovo.

Serge MÉTAIS

Auteur de *Histoire des Albanais. Des Illyriens à l'indépendance du Kosovo* – Fayard, 2006.

[1] L'acte d'accusation contre Hashim Thaçi et les trois autres anciens dirigeants de l'Armée de libération du Kosovo a été rendu public le 4 novembre. Il est consultable sur le site « Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor's office ». Cf. Case number KSC-BC-2020-06.

Kosova shënon Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit dhe Nderimit të Viktimave të Krimeve të Gjenocidit

Serbia ta pranojë gjenocidin kundër shqiptarëve të Kosovës

Përfaqësuesit e shoqatave të familjarëve të personave të pagjetur u kanë bërë thirrje institucioneve të bëjnë më shumë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Ata nga foltorja e Kuvendit të Kosovës kanë kërkuar nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare t'i bëjnë presion Serbisë në lidhje me këtë çështje. Ndërsa kryeparlamentarja Vjosa Osmani ka thënë se mospranimi i fajit nga Serbia është duke e mbajtur peng dialogun me Serbinë. Ajo ka theksuar se Serbia duhet të detyrohet të japë informata për të pagjeturit dhe për gjitha krimet që ka bërë në Kosovë. Në anën tjetër, kryeministri Avdullah Hoti ka kërkuar nga Serbia të kërkojë falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë. Po ashtu, ai ka kërkuar nga Serbia të kërkojë falje edhe për djegien e kufomave të civilëve shqiptarë, për varrosjen dhe zhvarrosjen e disahershme të tyre



gjenocidit kundër shqiptarëve. Ajo duhet të detyrohet që të japë informata për dhunën sistematike ndaj viktimave e, mbi të gjitha, për vendndodhjen e qytetarëve tanë të pagjetur", është shprehur Osmani. Thirrja që të mos jepen informata për gjetjen e varrezave masive në Serbi nga zyrtarët serbë, sipas Osmanit, është krim i ri që po bëhet. "Jemi këtu për të dëshmuar se krimi i kryer nuk mund të fshehet dhe se fshehja e krimin është krim i ri, po aq i tmerrshëm sa ai i pari; për t'i dëshmuar vetes e botës se rrëfimi mbi gjenocidin është i domosdoshëm, sepse ai dëshmon

të kaluarën tonë. Ikja nga të rrëfyerit për përjetimin është mohim i ekzistimit të tij. E ne duam të dëshmojmë sepse nuk duam të harrojmë. Ne duam të dëshmojmë sepse i duam 1 600 të pagjeturit tanë, të cilët regjimi i sotëm në Beograd i fsheh ende, janë historia e trishtë e këtij vendi, të cilën ne do ta themi pa frikë çdo ditë, derisa dhembja e këtyre nënave, baballarëve, motrave e vëllezërve, bijave e bijve jetimë të mos njihet dhe drejtësia për ta të mos vijë", ka thënë Osmani, duke shtuar se historia nuk do t'ua falë nëse nuk zbardhet fati i të pagjeturve. "Historia nuk do të na falë nëse ne provojmë të hapim një kapitull të ri libri, pa e lexuar e rilexuar me kujdes kapitullin e së djeshmes dhe të së sotmes. Ajo nuk do të na falë nëse nuk do të njihet tragjedia e vendit tonë, nëse gjenocidi i kryer nga shteti serb nuk do të emërtohet me emrin e vërtetë, me përmasën e vërtetë, dhe nëse nuk do të ketë drejtësi vendore e ndërkombëtare për viktimat. Historia nuk do të na falë nëse ne nuk do t'u japim zë mbi një mijë zërave të vrarë të fëmijëve tanë, shumë prej të cilëve vetëm foshnja disajavëshe ose disamuajshë.

Emrat e tyre qëndrojnë në themelet e pavarësisë sonë, por dhembja për ta do të shtohet për aq kohë sa Serbia nuk do ta pranojë fajin historik për gjenocidin e kryer. E dhimbja është në veçanti shumëfish më e madhe për fëmijët e pagjetur, që janë në mesin e mbi 1 600 bashkëqytetarëve tanë që akoma janë të zhdukur me dhunë e të fshehur nga Serbia", ka deklaruar Osmani.

Më tutje, zëvendëskryeministrja Albulena Balaj-Halimaj ka thënë se qytetarët e Kosovës kanë përjetuar "gjenocidin më të tmerrshëm të fund të shekullit 20-të". "Një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës dhe kryeministrit (Avdullah) Hoti lidhet me angazhimin që ky gjenocid të njihet në përmasa ndërkombëtare, si i tillë dhe do të duhet një trajtim adekuat i viktimave që i mbijetuan këtij gjenocidi dhe familjarëve të tyre që janë vrarë, apo konsiderohen të zhdukur", ka thënë Balaj-Halimaj. Në luftën e fundit në Kosovë konsiderohen se janë vrarë mbi 13 000 persona, prej tyre mbi 1 000 fëmijë. Aktualisht konsiderohen të pagjetur edhe mbi 1 600 persona, kryesisht shqiptarë.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit dhe Nderimit të Viktimave të Krimeve të Gjenocidit, familjarët e personave të pagjetur në Kosovë kanë kërkuar drejtësi dhe u kanë bërë thirrje institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që t'i bëjnë presion Serbisë në mënyrë që të japë të dhëna për personat e vrarë, të cilët mund të jenë të varrosur në varreza masive në territorin e Serbisë. Me këtë rast, Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të veçantë ku kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e shoqatave të familjarëve të personave të pagjetur nga lufta e fundit në Kosovë, të cilët kanë kritikuar qeveritë e Kosovës ndër vite se nuk kanë bërë mjaftueshëm për zbardhjen e fatit të familjarëve të tyre.

Nysrete Kumnova, përfaqësuese e shoqatës "Thirrjet e Nënave", i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të bëjë më shumë për të pagjeturit sepse, siç ka thënë ajo, "ndryshe dekadat po mundohen t'i fshehin gjurmët e krimin". Kumnova ka thënë se është kërkesë e shoqatës që drejton që të bëhet pjesë e delegacionit të Kosovës në dialogun me Serbinë. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se janë të gatshëm të ballafaqohen me Serbinë, duke ofruar edhe dëshmi për krimet e kryera në Kosovë nga shteti serb. Ligji për të Pagjeturit, ka thënë Kumnova, duhet të silltet me procedurë të përshtetshme në Kuvend pasi, sipas saj, me ligjet aktuale, familjarët e të pagjeturve janë të obliguar që të zgjedhin në mes të pensionit të pleqërisë dhe ndihmës që ofron shteti për familjarët e tyre të pagjetur. "Nuk

dua t'i mbyll sytë dhe asnjë nënë nuk do, pa na i kthyer më të dashurit tanë nga varrezat masive të Serbisë", ka thënë Kumnova, duke shtuar se familjarët e mbi 1 600 të pagjeturve që dy dekada jetojnë në ankth. Ndërsa Bajram Çerkini, kryetar i Shoqatës "Zëri i Prindërve", ka kërkuar që institucionet e vendit të bëjnë më shumë për zbulimin e fatit



të të pagjeturve. Çerkini u ka thënë deputetëve të mos presin që Serbia se do ta bëjë vetë këtë. "Kjo do trysni të madhe prej miqve që na kanë çliruar", ka thënë Çerkini.

Osmani: Serbia ta pranojë peshën historike të kryerjes së gjenocidit kundër shqiptarëve

Në këtë seancë ka folur edhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se mospranimi i fajit nga Serbia është duke e mbajtur peng dialogun me Serbinë, duke shtuar se kjo e fundit duhet detyruar që të japë informata për të pagjeturit dhe për krimet e tjera. "Serbia duhet ta pranojë peshën historike të kryerjes së

Hoti: Serbia duhet të kërkojë falje për krimet dhe gjenocidin e kryer në Kosovë

Kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se si rrallëkush në historinë e vonshme të Evropës, Kosova vazhdon të ballafaqohet me plagën e madhe të të zhdukurve. "Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit i nderojmë me pietet të gjithë civilët e pafajshëm kudo në botë. Qindra familje tona ende presim me ankth ndonjë lajm për fatin e më të dashurëve të tyre, të cilët u tretën pa shenjë gjatë krimeve dhe gjenocidit serb në Kosovë më 1998-'99", ka thënë Hoti, duke shtuar se bota e di kush

ka qenë viktimat dhe agresori gjatë luftës në Kosovë. "Bota e di çfarë ka ndodhur këtu, e di mirë kush ka qenë agresori e kush viktimat. Me gjithë pengesat e mëdha, dëshmitë e këtyre krimeve të kryera në zemër të Evropës vazhdojnë të dalin në dritë. Prandaj, pohojmë fuqishëm se provat e çmendisë serbe në Kosovë nuk mund të zhbëhen, sepse ato janë parë dhe janë evidentuar nga mbarë komuniteti ndërkombëtar. Duke e mbajtur përherë në kujtesë tragjedinë që ka përjetuar, Republika e Kosovës është e përkushtuar për të

ardhmen paqësore të rajonit dhe integrimin në familjen e kombeve të lira demokratike evropërendimore. Por, po ashtu, ne presim nga fqinja jonë veriore, Serbia, të kërkojë falje për krimet dhe gjenocidin e kryer, të kërkojë falje për djegien e kufomave të civilëve shqiptarë, për varrosjen dhe zhvarrosjen e disahershme të tyre. Përveçse një akt moral, kërkimfalja është edhe kusht elementar human për të ecur përpara kah pajtimi dhe mirëkuptimi në mes dy shteteve tona", është shprehur Hoti.

Institucionet e drejtësisë dhe EULEX-i, njëzëri në luftën kundër korrupsionit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 DHJETOR 2020 - Në Ditën Botërore Kundër Korrupsionit, ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, të mërkurën ka pritur në takim shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë, Lars-Gunnar Wigemark, përfaqësues nga Prokurori i Shtetit, Gjykatës Themelore të Prishtinës, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit. Gjatë këtij takimi temë diskutimi kanë qenë masat e ndërmarra dhe objektivat në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Ministri Selimi tha se korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik e shoqëror, dhe luftimi i tij mbetet një nga sfidat kryesore dhe një nga prioritetet madhore të Qeverisë së Republikës së Kosovës. "Shteti i së drejtës dhe luftimi i krimin të organizuar dhe korrupsionit vijnë kur infrastruktura ligjore nuk kursen asnjë zyrtar shtetëror, cilado qoftë pozita e tij në institucione. Kushdo që shkel ligjin duhet të përballlet me të", ka thënë ministri Selimi.

Ministria e Drejtësisë, tha Selimi, përmes Projektligjit për Agjencinë për Parandalim të Korrupsionit do t'i mundësojë këtij institucioni që të bëhet identifikimi i hapësirave që mundësojnë keqpërdorimin apo korrupsionin. Po ashtu, ministri Selimi potencoi se Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve sjell një dimension krejtësisht të ri të mbrojtjes së sinjalizuesve në pajtim me standardet dhe praktikën më të mira dhe paraqet

një instrument shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e interesit publik.

Ministri Selimi ka përmendur edhe Projektligjin për Avokaturën Shtetërore i cili obligon avokatët shtetërorë të ushtrojnë kallëzim penal kur hasin në rastet korruptive. "Përmes këtij Projektligji, Avokati i Përgjithshëm Shtetëror dhe avokatët shtetërorë obligohen që nëse gjatë kryerjes së detyrave zyrtare hasin në ndonjë shkelje ku ekziston dyshim i arsyeshëm për ndonjë element të veprës penale që ndërlidhet me kategorinë e veprave penale kundër korrupsionit zyrtar dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, të njëjtët ushtrojnë kallëzim penal në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës", ka deklaruar Selimi.

Në anën tjetër, shefi i Misionit EULEX, Lars Gunnar Wigemark, theksoi nevojën për bashkërendim të ngushtë dhe shkëmbim të informatave mes të gjitha palëve të interesit, në veçanti mes hetuesve të Policisë së Kosovës, prokurorëve, posaçërisht atyre nga PSRK-ja dhe gjykatave.

Shefi i Misionit të EULEX-it mirëpriti iniciativën e ministrit Selimi për mbledhjen e të gjithë partnerëve kryesorë dhe theksoi rolin bashkërendues të përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë së Kosovës. Nga Agjencia Kundër Korrupsionit, Kelmendi tha se mbeten të përkushtuar për realizimin e mandatit dhe kompetencave të kësaj agjencie konform kornizës ligjore në fuqi në fushat që lidhen me hetimin



dhe parandalimin e korrupsionit, me natyrë të korrupsionit, hetimin dhe zbulimin e rasteve mbrojtjen e sinjalizuesve,

përpjekjet për parandalimin e fenomenit të korrupsionit si dhe vetëdijesimin e publikut në hapat përpara drejt krijimit të një shoqërie ku sundojnë rendi dhe ligji.

Ndërsa nga institucioni i Prokurorit të Shtetit, Gjykata Themelore në Prishtinë dhe nga Policia e Kosovës, u tha se këto institucione janë mirë të koordinuara për veprimet në luftën kundër korrupsionit dhe do të vazhdojnë të jenë të përkushtuara për zbatimin e rendit dhe ligjit, megjithatë kërkojnë që të ketë edhe më shumë bashkëpunim nga qytetarët për t'i raportuar rastet e korrupsionit.

Lëvizja FOL kërkon rezultate të matshme në luftën kundër korrupsionit

"Dita Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit për Qeverinë dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës do të duhej të ishte një ditë në të cilën do të numëroheshin sukseset në luftën kundër korrupsionit. Fatkeqësisht, sukseset ndaj kësaj dukurie janë në një nivel të papërfillshëm", kështu është thënë në komunikatën e Lëvizjes FOL. Sipas FOL-it, të dhënat nga raportet kredibile kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat specifikojnë pjesë të korrupsionit, janë alarmante. "Sipas raportit të UNDP-së qytetarët e Kosovës kanë renditur papunësinë, korrupsionin dhe varfërinë si tri

problemet themelore me të cilat përballlet Kosova aktualisht. Sipas studimit të Odës Ekonomike Amerikane për vitin 2019, i cili ka matur aspektet kritike të korrupsionit, tregon se 72 për qind e bizneseve e shohin korrupsionin si një çështje shumë të rëndësishme në Kosovë, ndërsa më shumë se gjysma e tyre e konsiderojnë korrupsionin në Kosovë si sistematik", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes FOL. Në këtë komunikatë theksohet se raporti i vendit për Kosovën për vitin 2020 tregon se Kosova ka bërë përparim të kufizuar në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë të korrupsionit, në konfiskimin e

pasurive si dhe përmes krijimit të departamenteve speciale që trajtojnë me prioritet rastet në lidhje me korrupsionin e nivelit të lartë, të korrupsionit (dhe krimin e organizuar) në gjykata. "Deri më tash institucionet si prokuroria dhe gjykatat nuk kanë ndërmarrë dhe nuk po ndërmarrin veprimet e nevojshme me të cilat do ta dëshmonin përkushtimin e tyre ndaj luftës kundër korrupsionit. Andaj, në Ditën Ndërkombëtare kundër Korrupsionit Lëvizja FOL kërkon rezultate të matshme dhe veprime konkrete në luftën kundër korrupsionit, e jo fjalë boshe siç jemi mësuar t'i dëgjojmë zyrtarët shtetërorë për çdo ditë", është theksuar në komunikatën e Lëvizjes FOL.

Mungesa e oksigjenit dhe barnave nëpër spitale po u kushton me jetë qytetarëve

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh anëtar i Kryesisë së PDK-së, Donjet Bislimi, ka mbajtur një konferencë për media, në të cilën ka shprehur shqetësimin për gjendjen e rënduar të krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë sigurimin e vaksinës anti-Covid për shkak se në Kosovë është rritur numri i vdekjeve, duke tejkaluar shumë vende në botë.

Ai shprehu zemërimin ndaj Ministrisë së Shëndetësisë dhe qeverisë së Kosovës për

keqmenaxhimin e spitaleve dhe gjithë sistemit shëndetësor, që është demonstruar tashmë nga raportimet e mediave. "Mediat kanë dëshmuar tashmë për mungesën e kushteve bazike, të kontrolleve dhe izolimit të nevojshëm të spitaleve ku trajtohen pacientët e infektuar prej koronavirusit. Ndërkohë që gjasat janë të mëdha që kjo qeveri të dalë me suficit të madh për sa iu përket shpenzimeve buxhetore, qytetarët nuk kanë oksigjen, i cili është vital për mbijetesën e të sëmururve dhe detyrohen ta kërkojnë në treg privat. E njëjta situatë e rëndë shihet edhe me barna, ku Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë masa për t'i përmbushur



nevojat e pacientëve, të cilët po detyrohen t'i blejnë barnat në treg të zi me çmime të larta. Ne si PDK jemi të shokuar nga mungesa e oksigjenit në spitalet tona dhe dikush duhet të japë përgjegjësi për këtë", ka thënë

Bislimi. Ai ka kërkuar llogari nga institucionet kompetente për krizën e krijuar si shkak i mungesës së oksigjenit për pacientët me Covid-19 dhe bëri thirrje për mobilizim të përgjithshëm për menaxhimin e

kësaj krize.

Bislimi ka thënë se një tjetër problem madhor që po manifestohet sa i përket ballafaqimit me pandeminë është çështja e sigurimit të vaksinave anti-Covid. "Ndërkohë që zbulimi i vaksinave dhe fillimi i përdorimit të tyre në vendet perëndimore ka dominuar mediat ndërkombëtare dhe mobilizuar të gjitha qeveritë e rajonit, qeveria Hoti nuk ka shpalosur ende ndonjë plan se si dhe kur do t'i sigurojë vaksinat për qytetarët e Kosovës", ka thënë kryetari i Rinisë Demokratike të Kosovës (PDK), njëherësh anëtar i kryesisë së PDK-së, Donjet Bislimi.

Harruarje përtëritjeje e (pa)qëllimshme



Shkruan Agron HOTI

Sipas National Democratic Institute (NDI), zhvillimi i demokracisë varet nga 11 tregues kryesorë: 1. Të drejtat civile, 2. Të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, 3. Pjesëmarrja Civile dhe Politike, 4. Partitë politike, 5. Zgjedhje të Lira dhe të Ndershme, 6. Sundimi i Ligjit, 7. Kontrolli Ushtarak dhe Policor, 8. Llogaridhënia e Qeverisë, 9. Korrupsioni, 10. Media, dhe 11. Përgjegjshmëria e Qeverisë. Sigurisht që Kosova ka vetëm 12 vjet shtetësi dhe se ende është në nivelet fillestare të përmbushjes së treguesve të lartpërmendur. Do të ishte befasia e shekullit po të ishte e kundërta. Ndërkohë që, ka shumë shtete në BE, me traditë shtetërore mbi 100-vjeçare, që as për së afërmi nuk kanë arritur t'i përmbushin treguesit e lartpërmendur të demokracisë. Por kjo, në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë arsytim dhe dekurajim për Kosovën për të mos u mundur t'i përmbushë. Megjithatë, arritja e treguesve të demokracisë varet nga shumë faktorë historikë e aktualë, nga kapaciteti i atij shteti dhe para se gjithash vullneti politik pa të cilin nuk mund të hapet rruga dhe fryma e përparimit dhe zhvillimit të demokracisë. Krahas nevojës së madhe për përmbushje të treguesve e tjerë të demokracisë, Kosova ka nevojë po aq të madhe për përmbushje të treguesit 4 që ka të bëjë me partitë politike, pra me mënyrën se si kanë funksionuar, si funksionojnë ato sot dhe ç'frymë mbretëron dhe alternativat brenda tyre për të ecur përpara. Pa u reformuar partitë politike përmes debatit gjithëpërfshirës e të sinqertë që nga baza e deri te koka dhe pa iu nënshtruar votës së lirë gjithandaj strukturave partiake, as që mund të reformohen. Pastaj, nëse reformimi i nuk i paraprin demokratizimit të mëtejshëm të partive politike, çdo përmbushje e treguesve tjerë të demokracisë bëhet e vështirë, nëse e pamundur. E realiteti e dëshmon që partitë politike në Kosovë nuk japin përshtypjen që marrin vendime përmes debateve gjithëpërfshirëse dhe të sinqerta që nga baza e deri te koka. Ato - para çfarëdo gjithëpërfshirjeje kohezive politike më shumë preferojnë përjashtimin e shumicës dhe

promovimin e pakicës që veç sa e ka humbur përfaqësimin dhe lidhjet në terren dhe që s'para më u bën për bazën dhe problemet e vërteta të qytetarëve.

Duhet theksuar faktin që reformimi i partive politike është proces po aq kompleks sa edhe vetë reformimi i administratës publike të një shteti. Kjo për faktin se partitë politike janë grupime të interesave të ndryshme dhe kjo sigurisht që përbën pengesë të madhe për reformim. Të rralla janë ato parti që kanë mundur të reformohen duke qenë në pushtet. Shikoni Partinë Socialdemokrate (SPD) në Gjermani, e cila që nga viti 2005 ende nuk ka mundur ta merr veten për të fituar zgjedhje në Gjermani. Vazhdimisht thonë se janë duke ndërmarrë hapa reformues, por rezultati është vazhdimisht i mangët.

Ose, mjafton t'u referohemi përpjekjeve të vështira për reformimin e Partisë Demokratike në Shqipëri për të parë se sa e vështirë është një ndërmarrje e tillë. Hiq më lehtë nuk kishte kaluar, nëse ka kaluar, as Partia Socialiste. Pikërisht këto janë pasojat e drejtuarjes së një partie politike nga një pakicë, e cila përpos që moti ka humbur lidhjet me bazën dhe problemet e vërteta të qytetarëve, është mbërthyer në luftën e brendshme politike brendapartiake, së cilës nuk i shihet fundi. E nëse ka një shtet në Evropë që ka shpenzuar aq shumë mund e sakrificë për të zhvilluar demokracinë, kuptohet për aq sa ka mundur, Shqipëria do të duhej të ishte në vend të parë. Gjithsesi, që edhe përkundër zhvillimeve të shumta që kanë ndodhur atje, niveli i demokratizimit lë ende për të dëshiruar, ashtu sikurse lë në Kosovë, te shqiptarët në Maqedoni të Veriut dhe gjatë ku ka shqiptarë.

Harrohet fakti që reformat në shekullin 21 nuk përfundojnë kurrë, ashtu siç nuk përfundon kurrë dhe zhvillimi i demokracisë. Pikërisht, këtë fakt nuk kanë qenë në gjendje ta kapin, ta analizojnë dhe pse jo përbrendësojnë partitë politike në Kosovë. Po deshe të mbijetosh politikisht, reforma dhe përtëritja duhet të vazhdojnë pambarimisht, sepse aq të shpejta janë dinamikat zhvillimore sot në glob, sa që po u ndale, e ke humbur hapin. Ashtu siç nuk ndalet hulumtimi dhe inovacioni në ndërmarrje e korporata të ndryshme anekënd globit, njëjtë nuk duhet ndaluar puna hulumtuese, përtëritëse dhe pse jo inovative nëpër parti politike.

Të kthehem te Kosova. Një fjalë popullore thotë "ec me kohën". Njëri prej segmenteve që do të

duhej të kishte vazhdimësi zhvillimi është përgatitja e resurseve të nevojshme brenda partive politike. Pra, pa resurse të duhura as nuk ka shtet të mirëfilltë, as ndërmarrje e as parti politike. E përgatitja e resurseve - përpos që së pari duhet nënshtruar debatit gjithëpërfshirës, votës së lirë për të hyrë shëndetshëm dhe ndershëm brenda një partie - do të duhej nënshtruar formimit politik të strukturave partiake nëpër shkolla e institute të ndryshme që janë të specializuara për këtë punë.

Jo rastësisht partitë politike në botën demokratike kanë themeluar institute përkatëse, përmes të cilave formësojnë politikisht resurset politike. Nuk ndodh atje sikur te ne, të del një politikan të flet dhe mos ta kuptojë askush çfarë flet për shkak të gabimeve logjike pambarimisht të shumta në ndërtimin e fjalive dhe fjalimeve në tërësi. Nuk ndodh atje të thotë të jetë i majtë e veprimet t'i bëjë të djathta, ose e kundërta. Nuk duhet harruar faktin se përgatitja e resurseve, përpos që është e kushtueshme, merr shumë kohë.

Partitë politike në Kosovë në vend që të investojnë shumë dhe pandërprerë në resurse të reja dhe profesionale, ato përkundrazi e kanë mbyllur qarkun për prurje dhe as që u bën fare për resurse të reja. Kjo, sepse resurset e reja në të shumtën e rasteve shihen si rrezik për të vjetrat e futura shpesh nëpër elemente të shumta korruptive dhe çdo tentim-depërtim i ri brenda partive politike pa përjashtim, dekurajohet qëllimshëm qysh në start dhe pse jo shuhet në formën më të keqe të mundshme. Nuk janë të rastësishme garat e ndryra brenda për brenda partive politike, ku secili lufton secilin edhe pse thirret se i përket të

njëtit subjekt politik. Dhe kjo garë e ndyrë është bartur dhe shtrirë gjithandaj edhe në jetën institucionale, ndaj edhe sot kemi çoroditje institucionale të vazhdueshme.

Në vend që partitë politike të rekrutonin të rinj dhe të reja dhe më pas t'i përgatisin ata/ato përmes formimit të ndershëm dhe të shëndoshë politik, ato përkundrazi riciklojnë resurse të bjerra, të cilat s'mund të paraqesin më vlerë të shtuar për trendët dhe dinamikat e shpejta nëpër të cilat po kalon shoqëria jonë, rajoni dhe globi. Nëse trendi global sot - ashtu sikurse nesër -do të jetë dija, digjitalizimi dhe shpejtësia e paparë e dinamikave të zhvillimit dhe shumëdimensionale, atëherë partitë politike duhet vepruar konform trendit, e jo ta ndrydhin atë. Në qoftë se themi se kemi popullatën më të re në Evropë, atëherë këtë duhet ta dëshmojmë edhe me vepra duke mbështetur dhe promovuar rininë në të gjitha drejtimet e mundshme, përfshirë promovimin politik të tyre, e jo duke e penguar me çdo kusht atë.

Sikur partitë politike të përgatisnin me kohë kuadro të reja profesionale dhe t'i mbështesnin sinqerisht ato, sigurisht që do të kishin udhëheqës politikë të të gjitha niveleve, duke filluar nga drejtoritë nëpër komuna, kryetarë komunash dhe të gjitha nivelet politike qeveritare e parlamentare. Praktika e gjertanishme ka treguar që njerëzit ftohen për kandidatura të ndryshme politike aty për aty dhe pa asnjë plan, ndaj dhe rezultatet jo rrallë janë dëshpëruese.

Sigurisht që në garë politike dikush humb, por kur ke resurset e përgatitura me kohë si profesionalisht ashtu edhe politikisht, suksesi - nëse

jo sot - nesër do të jetë i garantuar.

Partitë politike, përpos nevojës imediate për resurse të reja profesionale, duhet të menaxhohen duke ndarë punët dhe përgjegjësitë për secilin, pa përjashtuar askënd, përkundrazi duke vepruar sipas motos "njeriu i duhur në vendin e duhur". Sikur të shkohej me këtë moto brenda partive politike dhe e njëjta të shtrihej pastaj edhe në jetën institucionale, atëherë performanca e përgjithshme, jo vetëm e partive politike, por edhe e institucioneve publike do të ishte shumë më e mirë se sa që është sot.

Prandaj, reformimi i partive politike ka vetëm një emër: gjithëpërfshirje e sinqertë, resurse të reja profesionale dhe formim adekuat politik. E të gjitha këtyre iu paraprin vullneti i partive për të ecur drejt reformimit të shëndoshë dhe të sinqertë, i cili më pastaj padyshim që do të nxiste profesionalizmin dhe zhvillonte demokracinë e brendshme. Përndryshe, mund të vazhdohet me riciklim resursesh, të cilat, edhe ashtu të bjerra tashmë, jo vetëm që nuk mund t'u sjellin më asgjë subjekteve që u takojnë, por ato s'kanë ç'u ofrojnë më as qytetarëve nga rutina e partishme e krijuar tashmë.

Kush i kap me sinqeritet nevojat e qytetarëve dhe ndërton frymën trenduale, do të ecën sigurt përpara, e kush ndrydh ndjenjat dhe promovon riciklimin, do të mbetet pambarimisht me sy e gojë hapur para përparimit politik të tjetrit. Fundja, reformimet e partive politike, për aq sa janë të nevojshme për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, janë po aq të nevojshme edhe për zhvillimin e mëtejshëm të vetë demokracisë në nivel vendi duke i hapur kështu rrugë prosperitetit dhe integritit në BE.



Avokati i Popullit: Kompensimi i parave të Trustit nga qeveria nuk përbën diskriminim

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kompensimi i mjeteve nga Qeveria e Kosovës të 10 për qind të kursimeve për pjesëmarrësit që kanë nën 10 mijë euro në Fondin e Kursimeve Pensionale, në situatën aktuale nuk ka karakter diskriminues, thonë në institucionin e Avokatit të Popullit.

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike Covid-19 është votuar më 4 dhjetor në Kuvendin e Kosovës dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare më 7 dhjetor 2020, që nënkupton edhe hyrjen në fuqi të këtij legjislativi.

Në bazë të këtij ligji, kontributpaguesit mund t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve pensionale në

Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Kontributpaguesit që kanë kursime deri në shumën 10 mijë euro, në rast të tërheqjes së 10-përqindëshit nga ana e tyre, Qeveria e Kosovës do t'i kompensojë ata brenda pesë vjetëve të ardhshëm.

Kurse ata që kanë mbi 10 mijë euro nuk do të rimburohen. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar Kushtetutës së Republikës së Kosovës, te neni për barazi para ligjit, thuhet se nuk parandalohet vënia e masave për mbrojtjen e grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. "Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e

masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato", thonë nga Avokati i Popullit. "Në shikim të parë, pa u lëshuar në analiza të thella të çështjes, pa të cilat Avokati i Popullit nuk mund të deklarohet përfundimisht, vërehet se Kushtetuta lejon vendosjen e masave të veçanta, të përkohshme të cilat janë të domosdoshme për ta zbutur ose për të eliminuar pabarazinë faktike, për të krijuar kushte më të favorshme për personat ose grupet e personave që gjenden në pozicion faktikisht të pabarabartë me të tjerët",

thuhet më tej në përgjigjen e Avokatit të Popullit.

Në rastin konkret, thuhet në përgjigje, bëhet fjalë për rrethana emergjente si pasojë e pandemisë, që ka sjellë disa grupe të caktuara në pozitë të pafavorshme. "Në rrethana të tilla, shteti është i obliguar që të ndërmarrë masa afirmative për të eliminuar apo së paku për ta zbutur pabarazinë faktike. Përndryshe, masat e veçanta kanë për qëllim vendosjen e barazisë dhe janë të përkohshme, sipas Kushtetutës, përkatësisht këto masa nuk kanë karakter diskriminues", thuhet në përgjigjen nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë

dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit.

Më 11 dhjetor 2020 do të fillojë procesi i aplikimit për kontributpaguesit për të tërhequr 10 për qind të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. Ky proces do të zhvillohet në mënyrë elektronike përmes një faqeje të veçantë të internetit, e cila tashmë është publikuar nga Fondi i Kursimeve Pensionale.



KRU 'Hidrodrini': Ndërprerjet e energjisë elektrike kanë shfaqur edhe shkurtime për furnizim me ujë

PEJË, 9 DHJETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjetës "Hidrodrini" ka bërë me dije se si rezultat i ndërprerjeve të energjisë elektrike nga ana e KEDS-it, ditët e fundit janë shfaqur

edhe ndërprerje të furnizimit me ujë. Sipas KRU "Hidrodrini", pjesa e sistemit e shpërndarjes së ujit funksionon me energji elektrike. "Si rezultat i ndërprerjes së energjisë

elektrike nga ana e KEDS-it, në disa zona të Rrafshit të Dukagjinit, ditët e fundit janë shfaqur edhe ndërprerje të furnizimit me ujë. Kjo ndodhë për shkak të njohura, meqë pjesë të sistemit tonë të

shpërndarjes së ujit, furnizohen me sistem të pompave të cilat funksionojnë me energji elektrike", thuhet në reagimin e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës "Hidrodrini".



Gjermania ia jep Kosovës 72.1 milionë euro, prej tyre 34 milionë euro grante



Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde dhe ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, kanë nënshkruar të mërkurën marrëveshje protokollin në kuadër të marrëveshjes kornizë të bashkëpunimit ekonomik me qeverinë gjermane për mbështetje të Kosovës, në vlerë 72.1 milionë euro, prej të cilave 34 milionë grante për periudhën 2020-2021

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Të mërkurën u përmbyllën negociatat qeveritare në mes të Kosovës dhe Gjermanisë për periudhën 2020-2021, ku qeveria gjermane ofroi një shumë prej 72.1 milionë euro për bashkëpunimin zhvillimor bilateral, prej të cilave 12.2 milionë janë për asistencë teknike dhe 59.9 milionë për asistencë financiare.

Në dy vjetët e ardhshme Gjermania do t'i fokusojë këto investime në mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, procesin e reformave të integritit evropian dhe në

investime në energji e eficientë të energjisë.

Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka theksuar se Gjermania është donatorja më e madhe bilaterale dhe investitorja e huaj më e madhe në Kosovë. "Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e saj të reformave që e bëjnë atë të përshtatshme për një të ardhme në Bashkimin Evropian. Do të vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Kosovë, ku fokusohemi në mbështetjen e arsimit profesional dhe zhvillimin e bizneseve. Gjermania, po ashtu, do t'i vazhdojë investimet

domethënëse në infrastrukturën publike në Kosovë, duke u fokusuar në energji, kanalizim dhe trajtim të mbeturinave", ka thënë ai.

Ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, ka vlerësuar lart bashkëpunimin e vazhdueshëm për 22 vjetët e fundit dhe ka mirëpritur zotimet e reja të Qeverisë Gjermane për Kosovën mbi bashkëpunimin zhvillimor. "Qeveria e Kosovës është duke punuar në drejtim të transformimit të ekonomisë dhe ndërtim të institucioneve në linjë me kërkesat e Bashkimit Evropian. Mbështetja e Qeverisë gjermane përmes projekteve kyçe infrastrukturore ka ndikim

tejet të madh në përmirësimin e kualitetit të jetës për qytetarët e vendit tonë dhe në emër të qeverisë zotohem që do të vazhdojmë t'i trajtojmë të gjitha me prioritet dhe t'u përmbahemi obligimeve që rrjedhin nga ato projekte", ka thënë ministrja Bajrami.

Ajo ka thënë se nga 72.1 milionë euro, 34 milionë euro janë grante për periudhën 2020-2021. "Projektet që do të marrin mbështetje grante janë 34 milionë euro: Ndërtimi i kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza për Prishtinën; Trajtimi i mbeturinave për Prishtinën dhe 6 komuna tjera; Mbështetje për arsimin profesional; Mbështetje për tregun e punës; dhe Mbështetje në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian", ka thënë ajo.

Në 2021-n dhe 2022-n bashkëpunimi zhvillimor me Gjermaninë do të fokusohet në fushat në vijim: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; mbështetje për arsimin

profesional të orientuar kah tregu i punës dhe aktivitetet për zhvillimin e sektorit privat, siç është përmes Parkut Inovativ-Trajnues Kosovaro-Gjerman në Prizren; Mbështetje për procesin e reformave të integritit evropian dhe kontribut drejt përmirësimit të shërbimeve për qytetarët e Kosovës, përfshirë projektin për trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta në përputhje me standardet evropiane; dhe Modernizimi i sektorit të energjisë: Investimet gjermane do të përmirësojnë eficientë e energjisë dhe të rrisin pjesën e burimeve të ripërtërishme, kryesisht përmes energjisë solare. Nga viti 1999, Qeveria gjermane ka investuar më shumë se 660 milionë euro në zhvillimin e Kosovës dhe përgjatë 22 vjetëve ka kontribuar vazhdimisht drejt përmirësimit të jetës së qytetarëve të Kosovës, përfshirë edhe asistencën lidhur me luftimin e pandemisë Covid-19.

Trusti do t'i bëjë pagesat 5 deri në 7 ditë pas aplikimit për tërheqjen e 10-përqindëshit

PRISHTINË, 9 DHJETOR (ER) - Aplikimi për tërheqjen e mjeteve prej 10 përqindësh nga Trusti do të nisë ditën e premtë nga ora 15:00. Të gjithë ata që aplikojnë për këto mjete në uebfaqen e veçantë të krijuar, pagesat nga Trusti do të bëhen 5-7 ditë pas

aplikimit, ka bërë me dije Jeton Demi, zëdhënës në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës. "Aktualisht jemi duke projektuar që pagesat e para do të bëhen brenda 5 deri 7 ditë prej momentit të aplikimit të kryhen pagesat për ata

kontribuues dhe mjetet t'iu kalojnë në llogari në banka", ka thënë Demi. Ai ka shtuar se kanë përgatitur një uebfaqe të re (www.trusti10.org), përmes së cilës mund të aplikohet dhe të menaxhohet situata dhe do të shmangen të gjitha vështirësitë.



Mbi 22 mijë euro janë investuar për renovimin e AMF-ve dhe QKMF-së në Kaçanik



Kaçanik, 9 dhjetor (ER) - Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, edhe këtë vit ka vazhduar investimet për renovimin e ambulancave dhe të QKMF-së në Kaçanik. Me këtë rast, ka përfunduar rregullimi i rrethojës së oborrit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Kaçanik si dhe rregullimi i një

pjesë të trotuarit për këmbësor, ku edhe është bërë lirim i hapësirës brenda oborrit të QKMF-së. Po ashtu, gjatë tërë vitit janë bërë investime edhe në ambulancat në terren, përkatësisht në AMF në Begracë, Dubravë, Shtrazë, Kaçanik i Vjetër si dhe në Biqec. Drejtoresha për Shëndetësi

dhe Mirëqenie, Sociale Diana Reka, ka thënë se këto investime kanë qenë pjesë e investimeve komunale për vitin 2020, që kanë pasur për qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për punëtorët shëndetësorë si dhe për trajtimin dinjitoz të pacientëve. Të gjitha këto investime i kanë kushtuar buxhetit komunal 22 mijë e 500 euro.

Në Gjilan inaugurohet shtëpia mobile e librit ABC



GJILAN, 9 DHJETOR (ER) - Është inauguruar të mërkurën në Gjilan shtëpia mobile e librit ABC, të cilën tash e tutje do ta shfrytëzojë librashitësi i njohur në Gjilan, Fehmi Halimi. Kreu i komunës, Lutfi Haziri, e ka falënderuar klubin rotarian "Gjilani" për këtë projekt,

duke thënë se kjo shtëpi është shembull i mirë i kujdesit ndaj njerëzve "E falënderoj klubin rotarian 'Gjilani', Gëzim Kllokoqin e Fadil Rrahmanin, me të cilët kemi punuar për rregullimin e shtëpisë së librit ABC, bashkëqytetarin, bashkëveprimtarin dhe ish-

të burgosurin politik të kohës, Fehmi Halimi. Do të bëjmë edhe shtëpi të tjera dhe kënde të leximit, përfshirë edhe përfundimin e bibliotekës së fëmijëve në lagjen Dardania. Urime Fehmi sepse tashmë jeni bartës i librit në Gjilan", ka thënë Haziri.

Drejtorja për Bujqësi në Drenas monitoron ndërtimin e serave

DRENAS, 9 DHJETOR (ER) - Drejtoresha e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Anita Avdullahu-Dvorani, e shoqëruar edhe nga menaxheri i projektit dhe komisionit për pranim teknik të serave, ka dalë në terren për të monitoruar nga afër ndërtimin e serave të fermerët përfitues të këtij projekti.

Ndërtimi i serave është duke u zhvilluar sipas projektit dhe sipas planit menaxherial të kontratës së lidhur ndërmjet DBPZHR-së dhe punëkryesit. DBPZHR-ja në Drenas ka njoftuar fermerët se projekti i ndërtimit të serave është në përfundim e sipër dhe prej 65 serave sa janë, deri më tani janë ndërtuar rreth 40 prej tyre.



Administrata komunale në Podujevë ofron shërbime për qytetarët gjatë tetë orëve të orarit të punës

PODUJEVË, 9 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nxjerrë vendimin e parë, sipas të cilit, administrata komunale e organizon punën për shërbim të pandërprerë për qytetarët gjatë tërë orarit të punës, prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Me qëllim të krijimit të

kushteve për ofrim të pandërprerë të shërbimeve për qytetarë, kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka marrë vendim që sektorët dhe shërbimet përkatëse të punëve me palë ta riorganizojnë punën dhe orarin e punës, në mënyrë që këto shërbime të kryhen pa

ndërprerë nga ora 8:00 deri në orën 16:00, gjatë ditëve të punës.

Në bazë të këtij vendimi drejtorët e drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Personelit bëjnë riorganizimin e orarit të punës sipas këtij vendimi, i cili hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.



Së shpejti pritet të përrurohet sistemi i ri i ujësjellësit në fshatin Gjonaj

PRIZREN, 9 DHJETOR (ER) - Pas përfundimit të punimeve për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Gjonaj të Hasit, kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka vizituar edhe punimet që po realizohen për rregullimin e rrugëve në këtë fshat, të cilët më pas do të shtrohen me

asfalt. Me këtë rast, kryetari Haskuka ka thënë se përpos rregullimit të infrastrukturës, Komuna e Prizrenit ka bërë edhe shtrimin e trotuareve me kubëza në rrugë të ndryshme të këtij fshati. Po ashtu, kryetari Haskuka theksoi se fshatin Gjonaj së shpejti do ta vizitojnë edhe për ta bërë

përfundimin e sistemit të ri të ujësjellësit, ku është bërë rregullimi i tërësishëm i rezervuarit të ujit dhe janë ndërtuar të gjitha gypat e sistemit primar dhe sekondar, përmes së cilës banorët e fshatit Gjonaj së shpejti do të kenë qasje në ujë të pijshëm 24 orë.

Detaji që dekodon një kryevepër

Një poçe e vogël argjile në pikturën “Las Meninas” të Velazquezit, zbërthen misterin e një prej veprave më të mëdha të shekullit XVII, shkruan kritiku i artit, Kelly Grovier. Pjesë të shkrimit të tij, Telegrafi përmbledh si më poshtë..

Ndonjëherë një poç është vetëm një poç. Ndonjëherë është portal në një plan tjetër të perceptimit. Në kryeveprën e Diego Velazquezit të shekullit XVII, “Las Meninas” (Zonjat e oborrit), një tërësi e hijeve dhe pasqyrave, si dhe një enë balte e vogël e pavlerësuar në qendër të kanavacës, e shndërrojnë veprën nga një pamje e çrregullt e jetës së oborrit mbretëror, në një traktat për natyrën iluzore dhe transcendentale të ekzistencës. Fshije atë enë prej argjile nga

heshtur duron shputën e një xhuxheje të re, pranë së cilës është një xhuxhe më e moshuar që na shikon, duke sforcuar ndjenjën se piktura po e ndjek çdo lëvizje tonën për aq sa jemi duke e shikuar. Pas dy xhuxheve është shoqëruesja e infantës, që mban zi e që rri pranë trupprojës mendimet e të cilit fluturojnë teksa ajo flet.

Përmes një dere të hapur në pjesën e prapme të pikturës, një figurë e shfaqur si rastësisht, shambelani i mbretëreshës,



qendra e pikturës së Epokës së Artë Spanjolle, dhe pushon pulsi i saj misterioz që ka marrë vëmendjen e vëzhguesve për më shumë se tre shekuj e gjysmë, qëkur Velazquezit e krijoi më 1656. Për të kuptuar sesi prania, në dukje e rastësishme e një qeramike artizanale nga Amerika Latine, bëhet lenta vizionare përmes së cilës e njohim botën, duhet së pari ta kujtojmë kontekstin kulturor ku piktura u krijua, dhe atë që kjo pikturë synon të portretizojë. Në një aspekt, vepra është autoportret i artistit 57-vjeçar, i bërë katër vjet para vdekjes së tij më 1600 – pasi i kishte kaluar më shumë se tri dekada si piktor i oborrit të mbretit Filipi IV i Spanjës. Paleta është në dorë, në anën e majtë të pikturës, ndërsa një si “selfie” e Velazquezit na vështron thuasje jemi subjekti që ai ishte i zënë për ta paraqitur në kanavacën e madhe para tij – pikturë brenda një pikturë, sipërfaqen imagjinare të së cilës nuk mund ta shohim. Dhoma e ndriçuar dobët, në Pallatin mbretëror të Madridit në të cilën Velazquezit rri pezull, është një si rrëmujë pa koreografi me një grup të papërshtatshëm të oborrtarëve. Në pjesën e përparme të figurës, në të majtë të Velazquezit, shohim infantën pesëvjeçare Margaret Theresa, vajzën e mbretit Filipi IV i Spanjës, dhe Marianan e Austrisë me disa shoqëruese – zonjat “oborrtare”. Në anën e djathtë të pikturës, një qen i madh dhe i

largohet nga sfera e pikturës, por jo para se të ndalet për të na hedh një vështrim, sikur të ishte në ankth se mund ta ndjekim tek e panjohura që është përtej. Në të majtë të asaj dere, një pasqyrë reflekton fytyrat e fanitura të mbretit dhe të mbretëreshës, vendndodhja fizike e të cilëve nuk merret parasysh. Ata janë atje, por jo atje. Janë këto dy aspekte të veprës – dera e hapur përmes së cilës shambelani del dhe fytyrat mbretërore në pasqyrën fantazmë, ato që kanë shtyrë vëzhguesit e pikturës për të dyshuar se ka më shumë lojë sesa ajo që neve na bie në sy.

Prania e munguar e mbretit dhe e mbretëreshës (të cilët janë në pikturë, por jo në skenë) na detyron të mendojmë se kjo është një vepër filozofike në lidhje me substancën e substancës dhe këtuhën e këtushit, si një kornizë e ngrirë e jetës në pallat. Gjëgjëza e reflektimit të tyre na bënë me dije se nuk jemi vëzhgues pasivë, por se kërkojmë në mënyrë aktive të kuptojmë se ku janë ata. A i pozicionon pasqyra atje ku jemi ne, nga jashtë, duke i parë subjektet e një portreti të Velazquezit në fazën e fillimit apo të mbarimit? Apo, pasqyra e zbulon atë që tashmë është në atë kanavacë të madhe, shpina e së cilës është kthyer kah ne: një reflektim imagjinari i sipërfaqes së një pikturë imagjinare që portretizon disa figura vendndodhjet imagjinare të të cilave veç mund t'i imagjinojmë!



Enigma “Las Meninas” luan me mendjen tonë. Nga njëra anë, linjat e perspektivës së kanavacës konvergojnë në një pikë të zhdukur brenda një dere të hapur, duke tërhequr vështrimin. Nga ana tjetër, shkëlqimi i pasqyrës e kthen vëmendjen tonë te piktura, për të menduar pozicionin e spektatorëve mbretërorë, pamjet e paqarta të të cilëve e ndjekin këtë vepër. Ne vazhdimisht tërhiqemi brenda dhe jashtë pikturës, teksa dhoma pa shumë dritë, e përshkruar nga Velazquezit, bëhet një dimension çuditërisht elastik që është kalimtar dhe i përgjeshëm – hapësirë e dukshme dhe e imagjinuar.

Në biografinë e saj të shkëlqyeshme, “Njeriu në zhdukje: Në kërkim të Velazquezit”, shkrimtarja dhe kritikja e artit, Laura Cumming, reflekton aftësinë e jashtëzakonshme të pikturës “Las

më shumë si halucinacion ose si një vizion mistik, sesa si një pikturë.

Ndoshta kështu është. Midis objekteve në pikturë, një enë modeste që i ofrohet Infantës së re (dhe neve), nga një shoqëruese, në një pjatë argjendi, nga bashkëkohësit mund të njihet si mishërim i vetive të ndryshimit të mendjes dhe trupit. Të quash dukjen e asaj qeramike të thjeshtë si “të botës tjetër”, kjo është më shumë se hiperbolë poetike. E njohur si bukaro (búcaro), sipas historianit të artit, Byron Ellsworth Hamann – i cili ka gjurmuar origjinën e mundshme të shumë prej objekteve që zbukurojnë punën e Velazquezit (përfshirë atë tabaka argjendi) – shkëlqimi i veçantë i enës dhe ngjyra e kuqe e ndezur e identifikojnë si produkt të Guadalajaras në Meksikë, që ishte në modë në qarqet aristokrate spanjolle të shekullit XVII (për



Meninas” për të paraqitur “një vizion kaq të saktë të realitetit” teksa në të njëjtën kohë mbetet “aq mister i hapur”. “Njohuria”, shkruan ajo, “se e gjithë kjo arrihet me anë të furçave, se këto janë veç figura të pikturuara, nuk e dobëson aq shumë iluzionin sa e thellon magjepsjen. E gjithë sipërfaqja e ‘Las Meninas’ ndihet e gjallë te prania jonë”. Vlerësimi i saj për fuqinë e çuditshme të pikturës, për “misterin”, “iluzionin” dhe “magjepsjen”, ka efekt pothuajse psikotropik tek ne – gjendje e ngjashme me ekstazën. Cumming e përshkruan madje

vajzat dhe gratë). Pasoja kimike të konsumimit të argjilës së asaj ene, ishte zbritja e lëkurës si një fantazmë pothuajse eterike.



Dëshira për të ndryshuar tonin e lëkurës mund të gjurmohet që në antikitet dhe është nxitur nga një sërë motivimesh kulturore. Që nga mbretërimi i Mbretëreshës Elizabeth, çehrrja e zbehtë dhe lëkura artificialisht e bardhë, në Evropë merrej si masë e bukurisë. Në klimat më të ngrohta mendohej se lëkura e zbehtë ishte provë e pasurisë dhe se jetesa nuk varej nga puna e kryer në rrezet e diellit të ashpër që e errëson lëkurën.

Sado e çuditshme të duket, konsumimi i baltës bukaro, për të ndryshuar pigmentin, ishte më pak i rrezikshëm se disa alternativa më bashkëkohore, të tilla si ljerja e fytyrës me keruzin venecian (një pastë e bërë nga plumbi, uthulla dhe uji) që rezultoi me helmim të gjakut, rënien e flokëve dhe me vdekje. Por, kjo nuk do të thotë që gëllitja e argjilës bukaro nuk kishte pasoja, përfshirë shterim të qelizave të kuqe të gjakut, paralizën e muskujve dhe shkatërrimin e mëlçisë. Ajo gjithashtu shkaktonte halucinacione.

Sipas autobiografisë së piktores dhe mistikes Estefanía de la Encarnación, botuar në Madrid më 1631, efekti narkotik i saj bënte “ta shihte Zotin më qartë”.

Kur i analizojmë efektet fiziologjike dhe psikotropike të varësisë nga bukaro, në enigmën shumëvjeçare të “Las Meninas”, piktura merr një pamje tjetër. Nëse shihni nga afër, furça e Velazquezit tregon drejtpërdrejt një pigment në paletë, me të njëjtën ngjyrë të kuqe pulsuese si ajo e bukaros. Infanta e zbehtë duket se rri pezull mbi dysheme – efekt ky i arritur nga hija delikate. Edhe prindërit e infantës, imazhet e të cilëve rrinë mbi bukaro, duken më shumë si shpirtra holografikë të projektuar nga një dimension tjetër, sesa reflektime në një pasqyrë.

Kështu, ne shohim pikturën për atë që është – jo vetëm një fotografi e një çasti në kohë, por meditim mbi shuarjen e botës materiale dhe tretjen e vetes sonë. Gjatë shërbimit të tij prej katër dekadash në oborr, Velazquezit dëshmoi zvogëlimin gradual të sundimit të mbretit. Bota e tij po rrëshqiste. Kështu, bukaro, si trofe i eksploatimit kolonial futet në skenë si simbol mirazhi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina fiton derbin ndaj Gjilanit, Drita shkëlqen në Drenicë

Tri skuadra në Superligë të mërkurën kanë shënuar fitore me rezultat 3-0. Spikat fitorja e Prishtinës në derbi me Gjilanin, kurse triumfuese dolën edhe Drita dhe Feronikeli



pasi kanë mbetur ende në kuotën e gjashtë pikëve dhe larg skuadrave të tjera. Në minutën e 9-të Maliqi shënoi golin e parë për vendësit, derisa në fund të pjesës së parë Malaj realizoi për 2-0. Në pjesën e dytë vendasit e drejtuar nga Klodian Duro shënuan edhe golin e tretë nëpërmjet Simonovskit. Duhet cekur se skuadra pejane nga minuta e 27-të luajti pa një futbollist, pasi Rahoviq u ndëshkua me karton të

kuq. Feronikeli ngrehet në pozitën e katërt me 23 pikë, Besa vazhdon të jetë e fundit me vetëm 6 pikë.

Sot zhvillohen dy ndeshje

Në kuadër të javës së 17 në Superligë, sot (e enjte) zhvillohen dy ndeshje. Ballkani i Ismet Munishit pas humbjes nga Drita në fundjavë, sot kërkon të këndellet dhe t'u rikthehet

SUPERLIGA		
Sot takohen:		
Ballkani - Trepça '89		
Arbëria - Llapi		
Gjilani - Prishtina		0-3
Drenica - Drita		0-3
Feronikeli - Besa		3-0
Tabela		
		Pikë
1. Drita	16	39
2. Ballkani	15	35
3. Prishtina	16	28
4. Feronikeli	17	23
5. Gjilani	16	23
6. Arbëria	16	20
7. Trepça '89	16	20
8. Drenica	17	18
9. Llapi	16	14
10. Besa	17	6

fitoreve në përballje me skuadrën e Trepçës '89. Mitrovicasit në xhiron e fundit e mposhtën skuadrën e Gjilanit dhe befasinë e synojnë edhe në ndeshjen që zhvillohet në Suharekë. Në ndeshjen tjetër Arbëria e pret skuadrën e Llapit.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 DHJETOR - FC Prishtina, pas barazimit në fundjavë me Feronikelin në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri", të mërkurën u është rikthyer fitoreve duke e mposhtur në derbi Gjilanin (0-3). Gjilani me këtë humbje thëllon edhe më shumë krizën e rezultateve në këtë edicion, kurse Prishtina vazhdon t'i ndjekë Ballkanin dhe Dritën. Kryeqytetasit e mbyllën pjesën e parë me epërsi prej dy golave, derisa shënues ishin Ylber Kastrati (autogol) dhe Leotrim Kryeziu. Pesë minuta para fundit të ndeshjes, Prishtina e shënoi edhe golin e tretë nga penalltia me anë të Lilajt. Kryeqytetasit përforcohen në pozitën e tretë me

28 pikë, kurse Gjilani bie në pozitën e pestë me 23 pikë. Në Skenderaj fitore të madhe ka shënuar skuadra e Dritës, e cila e ka mposhtur Drenicën me rezultat 0-3. Kuqezinjtë u bënë ballë kampionëve në fuqi të Superligës deri në minutat shtesë të pjesës së parë, kur skuadra gjilanase kaloi në epërsi me golin e shënuar nga Almir Ajzeraj. Në fillim të pjesës së dytë, Fidan Gërbeshi realizoi nga penalltia për 0-2. Golin e tretë për gjilanasit e shënoi në fund të ndeshjes Betim Haxhimusa. Drita përforcohet në vendin e parë me 39 pikë, kurse Drenica është në vendin e tetë me 18 pikë. Fitores të mërkurën i është gëzuar edhe Feronikeli që e mposhti në Drenas, Besën e Pejës (3-0). Pejanët assesi nuk po mund të këndelën në këtë kampionat,

Ponte e fiton derbin e skuadrave nga Prizreni

PRIZREN, 9 DHJETOR - Ponte Prizreni e ka mundur Bashkimin në derbin e qytetit me rezultat 81:77 (19:28, 19:15, 23:17, 20:17) në kuadër të javës së gjashtë të Prince Caffë Superligës. Ndeshjen më mirë e nisi Bashkimi, duke fituar çerekun e parë 19:28. Por, perioda e dytë ishte më e barabartë, madje Ponte u rikthye në lojë, duke qenë më e mirë dhe fitoi këtë pjesë 19:15, derisa skuadrat shkuan në pushim me rezultat 38:43. Ponte vazhdoi mirë edhe në periudhën e tretë duke e fituar 23:17, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 61:60. Drama vazhdoi edhe në 10 minutat e fundit. Ponte Prizreni kishte epërsi deri në 11 pikë, por

në fund Musab Mala me dy trepikësha ngushtoi shifrat në 79:77. Më pas Urim Zenelaj realizoi një nga dy gjuajtjet e lira, kurse Nikola Vukçević i Bashkimit nuk shënoi për tri pikë dhe në fund Ponte Prizreni fitoi 81:77. Te Ponte Prizreni u dalluan Arti Hajdari me 28 pikë e gjashtë kërcime, Joshua Martin me 13 pikë e 17 kërcime, kurse te Bashkimi më të dalluarit ishin Shazville Carter me 16 pikë e nëntë kërcime, Nikola Vukçević me 24 pikë dhe Musab Mala me 18. Ponte Prizreni ka tri fitore dhe tri humbje, kurse Bashkimi një fitore dhe pesë humbje.



Penza mposhti Prishtinën, fitojnë Vëllaznimi dhe Bashkimi

Të mërkurën u zhvillua xhiroja e nëntë e Superligës së Femrave.

Ndeshja kryesore ishte ndërmjet Penzës dhe Kosovahome Prishtinës, ku fitore shënoi skuadra pejane me rezultat 68:64 (20:9, 10:27, 16:16, 22:12). Skuadra vendase e nisi ndeshjen më mirë, duke fituar çerekun e parë me shifrat 20:9. Në periodën e dytë u kundërpërgjigjen mysafirët 10:27, duke shkuar në pushim 30:36. Në periodën e tretë u zhvillua ndeshje e barabartë 16:16, kurse drama ndodhi në 10 minutat e fundit. Penza nuk dorëzohet dhe arrin ta barazojë rezultatin, duke e bërë ndeshjen shumë interesante. Në minutën e fundit

të rezultatit 64:64, kapitenia e Penzës, Valbona Bytyqi, shënoi katër pikë për fitoren e skuadrës së saj. Bytyqi e mbylli ndeshjen me 32 pikë, kurse te Kosovahome Prishtina më e dalluara ishte Enxhi Khanaj me 18 pikë e 23 kërcime, kurse 18 pikë shtoi edhe Besjana Martinaj. Penza ka katër fitore dhe pesë humbje, kurse Kosovahome Prishtina pesë fitore dhe katër humbje. Bashkimi u është kthyer fitoreve, duke mundur Kastriotin në udhëtim 58:94 (18:18, 21:27, 6:30, 13:19). Ndërsa Vëllaznimi ka shënuar fitore të pritur ndaj Trepçës me rezultat 64:39 (13:7, 13:6, 15:11, 23:15).

U17 dhe U19 mësojnë kundërshtarët e kualifikimeve për Evropianin 2022

NION, 9 DHJETOR - Në selinë e UEFA-s në Nion është tërhequr shorti për kualifikimet e Kampionateve Evropiane 2022 për ekipet kombëtare të grupmoshave 17 dhe 19 vjeç.

Përfaqësuesja U17 e Kosovës bën pjesë në Grupin 9, së bashku me Austrinë, Slloveninë dhe Ishujt Faroe. Ndërkaq, Përfaqësuesja U19 e Kosovës do të luajë në Grupin 10, ku bëjnë pjesë edhe

Norvegjia, Gjeorgjia dhe Uells. Ndeshjet kualifikuese në të dyja grupmoshat do të zhvillohen në formë mini-turneu në vjeshtën e vitit të ardhshëm, ku të dyja ekipet e para në secilin grup dhe katër

ekipet më të mira të vendeve të treta do të kalojnë tutje. Në ditët vijuese UEFA do t'i vendosë datat e sakta të këtyre kualifikimeve dhe vendin organizator të mini-turneut në secilin grup.



Mick: Krenar që do ta rikthej mbiemrin Schumacher në Formula 1

BERLIN, 9 DHJETOR - Pasi triumfoi këtë vit në botërorin e Formula 2, piloti 21-vjeçar gjerman Mick Schumacher do të garojë sezonin e ardhshëm në Formula 1 me makinën Haas. Ai është djali i legjendës Michael Schumacher, shtatë herë kampion bote në F1,

ndaj prania në pistë e Mickut shihet me shumë kureshtje nga të gjithë. "E di që ndaj meje do të ketë shumë presion, por nuk e vë re shumë këtë gjë. E dua këtë sport, e pëlqej atë që bëj, ndaj e shoh të lehtë të punoj dhe t'i realizoj ëndrrat e mia. Për mua

është një nder që rikthej në këtë sport mbiemrin Schumacher", ka thënë në një intervistë për "Bild", Mick Schumacher. Piloti i ri gjerman u shpreh se gjatë këtyre muajve do t'i rishohë të gjitha garat që ka zhvilluar babai i tij, si një pjesë e

përgatitjes për debutimin në Formula 1. "Mendoj se t'i shohësh garat e vjetra ka kuptim edhe pse ky sport është zhvilluar shumë. Unë nuk do të shoh vetëm ato të babait tim, por edhe ato të viteve të fundit", ka deklaruar Mick Schumacheri.



Shkëndija merr fitoren e tretë rresht, Shkupi ndalet nga Vardari

TETOVË, 9 DHJETOR - Shkëndija nuk fali as në javën e 16-të të kampionatit të Maqedonisë së Veriut, pasi bëri detyrën ndaj Belasicas në Tetovë duke fituar me rezultatin 2-0. Fitorja e 3-të radhazi për skuadrën e Gjokës në kampionat, me Shkëndijën që u shkëput në krye duke e çuar në 6 pikë dallimin nga ndjekësja më e afërt që është Shkupi me skuadrën tjetër shqiptare që ngeci në një barazim 1-1 përballë Vardarit, raporton "SS". Golat për Shkëndijën nga një për çdo pjesë u realizuan nga mbrojtësi Egzon Bejtulai dhe sulmuesi kryesor Besart Ibraimi. Një gol i të përherëshmit gambianit Darboe që është kryegolashënues i kampionatit me 16 gola, 2 më shumë se Ibraimi, pak para fundit i evitoi humbjen Shkupit në derbin ndaj Vardarit që u mbyll në barazim 1-1. Për sa iu përket skuadrave të tjera shqiptare që luajnë në ligën e parë të Maqedonisë së Veriut, në ndeshjet e raundit të 16-të, Struga barazoi 0-0 ndaj Sileksit në transfertë, ndërkohë që Renova u mposht 3-1 në transfertë ndaj Rabotniçkit.



Filloi ndërtimi i tribunave dhe zhveshtoreve të reja në stadiumin e qytetit në Malishevë

MALISHEVË, 9 DHJETOR - Të mërkurën kanë filluar punimet për ndërtimin e zhveshtoreve të tribunave të reja në stadiumin e qytetit "Liman Gegaj" në Malishevë. Në ceremoninë e fillimit të punimeve ishin të pranishëm nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, drejtori i Sportit, Rexhep Mazreku, drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, anëtarët e KK të Malishevës, Alban Mazreku, Alban Krasniqi dhe Valon Krasniqi, si dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë komunale. "Sporti në këto vitet e fundit është duke na bërë krenar neve si Malishevë, në të gjitha lëmenjtë e sportit, por në veçanti futbollit, si sporti më i popullarizuar dhe ne kemi obligim që të krijojmë kushte më të mira për sportin, përmes investimeve. Në këtë rast, për ekipet që luajnë do të kenë ambiente më të mira me zhveshtore dhe ambiente të tjera



përcjellëse, po ashtu rriten edhe tribunat për shikuesit", ka thënë nënkryetari Hajdin Berisha. Edhe drejtori i DKRS-së, Rexhep Mazreku, u shpreh i kënaqur që kanë filluar punimet për zgjerimin e hapësirës dhe krijimin e kushteve më të mira në stadium. Drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina, ka

bërë me dije se projekti është dyvjeçar dhe deri në fillimin e sezonit të ri të garave, zhveshtoret dhe tribunat do të jenë gati. "Ky është investim i miratuar në Kuvendin e Komunës së Malishevës, projekt i miratuar në Kuvendin e Komunës dhe ka një shumë prej rreth 250 mijë eurove", ka bërë me dije Morina.

SHKURT

Prishtina kundër Barcelonës në Ligën e Kampionëve

Mabetex Prishtina ka mësuar kundërshtarin në futsall në kuadër të fazës së dytë së Ligës së Kampionëve. Skuadra e Prishtinës që është themeluar vetëm para pesë vjetëve do të përballet me Barcelonën. I gjithë shorti ende s'është kompletuar, derisa Prishtina do të përballet me klubin më të mirë në botë. Ndeshja do të zhvillohet mes 12-17 janar 2021.

Barça nuk e shkarkon Koemanin

Humbja në shtëpi kundër Juventusit në Ligën e Kampionëve konfirmoi krizën e Barcelonës në këtë sezon. Nisja zhgënjyese në La Liga dhe disfata e fundit në grupin e Ligës së Kampionëve ka detyruar skuadrën katalunjase dhe trajnerin Ronald Koeman të përballet me një "stuhi" kritikash. Momentalisht holandezi e ka të sigurt bankinën. Zërat për një shkarkim të mundshëm të tij janë hedhur poshtë nga klubi. Me anë të një deklarate për mediat, presidenti i përkohshëm Tusquets ka bërë me dije "Koeman do ta vazhdojë punën me Barcelonën".

Hardeni 'kërcënon' Houstonin me largim

Pas disa ditësh bojkot, basketbollisti James Harden është rikthyer në Teksas dhe ka nisur stërvitjen me skuadrën e Houston Rocketsit. Për momentin duket se është kthyer paqja mes palëve, por situata vijon të jetë e ndërlikuar për yllin e NBA-së. Mësohet se Hardeni i ka kërkuar skuadrës që të bëjë sa më shpejt përforsime për të qenë një ekip pretendent për titull. Në të kundërt, ai është gati të largohet në çdo moment, duke pranuar të jetë edhe pjesë e ndonjë shkëmbimi lojtarësh. "Mjekra" për momentin po stërvitet me ekipin, po zërat për një transferim te Golden State apo Brooklyn janë ende konkretë dhe situata mund të ndryshojë. Deri më datën 22 dhjetor, kur nis sezoni i ri, gjithçka mund të ndodhë me Hardenin.

Juve ofron Dybalan për Pogban

Juventus do të ofrojë Paulo Dybalan te Manchester Unitedi në formë shkëmbimi për Paul Pogban në janar, me përpjekjen për t'i shmangur shpenzimet financiare për të kthyer në klub mesfushorin francez. Sipas "Tuttosport", Juventus është "nxehur" nga komentet e agjentit të Pogbas, Mino Raiola, që tha se lojtari preferon largimin në janar. Ai madje theksoi se Juventus mund të jetë destinacioni i radhës i lojtarit. "Zonja e Vjetër" tani dëshiron ta shfrytëzojë rastin dhe ta marrë lojtarin pa bërë shpenzime. Dybala, që ka qenë edhe më herët i lidhur me një kalim në United, ka ngecur në Juve sivjet për shkak të lëndimeve.

Ronaldo: Jemi një ekip kampionësh, kështu fitohet Liga e Kampionëve

Hera e fundit përballë Lionel Messit në Ligën e Kampionëve ishte 9 vjet më parë por, mbi të gjitha, fansat e argentinës nuk kishin reshtur duke ia kujtuar se nuk kishte shënuar ende golin e parë ndaj "Pleshtit" në Evropë. Dhe hakmarrja e portugezëve ishte ekzemplare, dopietë, fitore 3-0 dhe i rrëmben rivalit të përjetshëm vendin e parë në grup. Prandaj, vetë Ronaldo nuk kishte se si të mos ishte euforik pas fitores. "Për mua është gjithmonë bukur që të rikthehem në Spanjë, por edhe në Katalonjë, sepse të luash në 'Camp Nou' është gjithmonë e vështirë. Barcelona është pa dyshim një nga skuadrat më të forta dhe më të mira me të cilat jam përballur por, fatkeqësisht, për të sot (dje) ata gjetën përballë një skuadër kampionësh. Por Juventus nuk është vetëm kjo, por në të njëjtën kohë një familje e vërtetë, e fortë dhe e bashkuar. Madje, duke luajtur kështu, nuk kemi asgjë për të pasur frikë përballë askujt, deri në fund të sezonit. Prandaj, forca djema, forca Juve, sepse kështu fitohet Liga e Kampionëve", ka thënë Ronaldo.

Kur fakti politik bëhet pjesë e historisë, e në e vëzhgojmë atë me një distancë të ftohtë, Xhevdet Bajraj na e shpërndan atë të konvertuar në një fabul të shkëlqyer. *Cuando el hecho político pasa a formar parte de la Historia, y lo observamos con fría distancia, Xhevdet Bajraj nos lo entrega convertido en una espléndida fábula*

Héctor Carreto, poet, meksikan. - *Poeta mexicano*

Imazhet që ai evokon janë të pastra dhe të bukura, me pak njerëz, si plagë të thella e të pastra. Kur përktheja këto imazhe unë u përpoqa ta kap pafajësinë e tyre, bukurinë e tyre fëmijërore, e cila bie kaq shumë në kontrast me makthe të errëta të kujtesës së Bajrajt

Las imágenes que evoca son limpias y hermosas, con poca gente, como heridas profundas y limpias. Al traducir estas imágenes, intenté capturar su inocencia, su belleza infantil, que contrastan de manera tan marcada con las oscuras pesadillas de la memoria de Bajraj

Alice Whitmore, përkthyesë e poezisë së Bajrajt nga gjuha spanjolle në angleze, Australi. - *Traductora de la poesía de Bajrajt del español al inglés, Australia*

Zëri që na detyron t'i modifikojmë kategoritë tona dhe referencat ndaj dhunës, tmerrit, vdekjes, braktisjes, vetmisë, e cila në këtë Amerikën tonë Latine (kaq e prirë për të shpallur dhimbje që nga heroina e romantizmit) ka qenë pretexti i poezisë pamfletuese të oportunitetit lirik

Voz que nos obliga a modificar nuestras categorías y referencias para con la violencia, el horror, la muerte, el abandono, la soledad, que en esta nuestra Latinoamérica (tan proclive a enunciar el dolor desde la heroína del romanticismo) ha sido pretexto de panfletarias poéticas de oportunismos líricos

Carlos Pineda, poet dhe eseist meksikan. - *Poeta y ensayista mexicano*

Poezia e Xhevdet Bajrajt nxit stuhi asociacionesh të lexuesi, e shkëput atë nga realiteti trivial dhe e strehon në një realitet të ri ku mbretëron meditimi për çështje substanciale të jetës, për botën, vetminë, dhimbjen dhe rrugëtimin e njeriut në jetë

La poesía de Xhevdet Bajrajt estimula la tormenta de asociaciones en el lector, lo separa de la realidad trivial y lo cobija en una nueva realidad donde reina la meditación sobre cuestiones sustanciales de la vida, sobre el mundo, la soledad, el dolor y el viaje del hombre en la vida

Zyrafete Shala, kritike letrare. - *Crítica literaria*

Poezi e dinjitetit mbi gërmadha. - *Poesía de dignidad sobre ruinas.*
Shqiptar Oseku, poet. - *Poeta*

6⁹⁹ €



KAFE ME NËNËN
CAFÉ CON MAMÁ

XHEVDET BAJRAJ



XHEVDET BAJRAJ

KAFE ME NËNËN poezi



CAFÉ CON MAMÁ poesia

Parathënien/ Prólogo: Adil Olluri



Adem Gashi (1953), poet, prozator dhe eseist, pa lënë mënjane njohuritë e paskajshme të tij për letërsinë shqiptare dhe për atë botërore, ka kryer studimet për letërsi dhe gjuhë shqipe në Universitetin e Prishtinës. Ka punuar mësues dhe ka qenë redaktor

reviste, drejtor televizionit, themelues i PEN-it të Kosovës, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, bursist i fondacionit gjerman "Heinrich Böll-Stiftung", këshilltar i lartë politik, drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Është anëtar i revistës *Akademia* dhe anëtar i Këshillit Drejtues i Institutit Albanologjik. Ka botuar 24 libra dhe është nderuar me rreth 50 çmime letrare. Është prezantuar në dhjetë antologji të lirikës shqipe. Edhe pse që dy vjet ka mbushur moshën e pensionistit, krijimtarinë letrare s'ka ndër mend ta pensionojë.

Libri i katërt me tregime, me rrëfenja e me parabola i Adem Gashit, *Lakorja e fatit*, dëshmon dhe ridëshmon autorin si krijues po aq të fuqishëm edhe në prozë. Madje tani mund të vlerësohet se toka e begatë e shkrimtarit, në kuptimin cilësor të vlerave artistike dhe të hijeshisë dhe të kënaqësisë estetike, është tregimtaria.

Lakorja e fatit çilet me tregimin uverturë *Pëllumbi i paqes* i rimarrë nga libri me titullin omonim (*Pëllumbi i paqes*, 1989), për të lakuar strukturalisht tre kapitujt pasues: *Terr, Dritë dhe mjegull* dhe *Matanë*, të cilët, në aspektin e konceptimit mbarështrues të tyre, na e vizatojnë kurbën tematike dhe motive, ideore dhe përmbajtjesore, filozofike dhe psikanalitike jo vetëm të rrëfimitarisë tregimtare, por edhe të gjenit krijues të autorit. Në këtë rast, besoj, vlen të veçohen dy aspekte: poetika moderniste me elemente të postmodernizmit dhe gërshetimi i formave dhe zhanreve letrare siç, fjala vjen, i prozës (tregimi, rrëfenjat), i poezisë (një lirikë me dy parabola poetike dhe një rrëfenjë-parabolë) si dhe i dramës, i konceptuar në trajtë të antidramës (*Maja e gishtit të madh të perandorit*).

4⁹⁹ €



Dr. Emin Z. Emini


LAKORJA E FATIT

ADEM GASHI


ADEM GASHI

LAKORJA E FATIT
(Tregime, rrëfenja dhe parabola)





REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1936
Datë:08.12.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit shpall këtë:

KONKURS
Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021

- SHFMU "7 Marsi" në Suharekë**
 - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
 - Një mësimdhënës/e për lëndën e gjuhës shqipe (për kohë të caktuar).
- SHFMU Ismet Jashari-Kumanova" në Javor**
 - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
- SHFMU "Naum Veqilharxhi" në Mohlan**
 - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (për kohë të caktuar).
 - Një punëtor-e teknik/ndihmës (për kohë të caktuar).
- SHFMU "Rilindja" në Njëpërbisht**
 - Një mësimdhënës/e për mësim klasor (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
- SHFMU "Besim Ndrecaj" në Maqitevë**
 - Një mësimdhënës/e për mësim klasor.(zavendësim i pushimit të lehonisë)
- Qerdhja e fëmijëve "Flutura" në Suharekë**
 - Katër edukatore për punktet në Gjinoc dhe Sopijë (për kohë të caktuar).


Kushtet: Për këto vende të lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA-MASHT nr.10/2018.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:


- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje) e vertetur tek noteri.
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)
- Certifikatat për trajnimet e kryera të akredituara nga MASHT(nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara të vertetuara nga noteri, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.


Për orarin e testimit me shkrim dhe intervistimit me gojë do të informoheni në faqen zyrtare të Komunesë së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.



Drejtori i DKA-së
Remza Bajselmani



REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05nr.1936 datum:08.12.2020

Na osnovu člana 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, člana 35. Zakona o pred-univerzitetkom obrazovanju u Republici Kosovo sa br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo, br.03 / L-068, AU br.10 / 2018 (Normativ o stručnom osoblju opšteg obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07 / 2017. godine za regulisanje postupaka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje ovo:

KONKURS
Za popunjavanje upražnjenih radnih mesta za školsku 2020/2021 godinu

- ONSS „7. Marsi“ u Suvoj Reci
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (zamena za porodiljsko odsustvo).
Jedan nastavnik/ca za predmet albanskog jezika (na određeno vreme).
- ONSS "Ismet Jashari-Kumanova" u Javoru
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (na određeno vreme).
- ONSS "Naum Vekilharxhi" u Movljanu
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (na određeno vreme).
- ONSS "Rilindja" u Nerperbištu
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (zamena za porodiljsko odsustvo).
- ONSS "Besim Ndrecaj" u Mačiteve
Jedan nastavnik/ca za razrednu nastavu (zamena za porodiljsko odsustvo)
- Dečji vrtić „Flutura“ u Suvoj Reci
Četiri vaspitačica za punkt u Dinovce i Sopino (na određeno vreme).
- Dva kuvara/ice za punkt u Dinovce i Sopino (na određeno vreme)


Uslovi: Za ova radna mesta objavljene na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema u skladu sa normativom AU - MONT-a br.10 / 2018.

Neophodna dokumentacija za konkurisanje:

- Obrazac prijave (zahtev) koji popunjava kandidat
- Diploma o nivou kvalifikacije ili uverenje umesto diplome koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija) overena kod notara.
- Izvod rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Dokaz o radnom iskustvu (ako ga imate)
- Sertifikati za završene obuke akreditovane od MONT-a (ako ih imate)

Kompletirana dokumenta se predaju fotokopirano i overene kod notara, dok se originalna dokumenta predstavljaju na intervjuu. Nepotpuna dokumenta i one koja stignu posle roka, komisija ne razmatra. Prijave se primaju i predaju u prijemnoj kancelariji u opštini Suva Reka. Rok za konkurs 15 (petnaest) dana od dana objavljivanja konkursa u novinama.

Bićete obavesteni o rasporedu pismenog testa i usmenog intervju na zvaničnoj veb stranici opštine Suva Reka i na oglasnoj tabli ODO.



Direktor ODO
Remza Bajselmani

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Air Tech Limited Kg” L.L.C. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811395971 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Air Tech Limited Kg” L.L.C.. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811395971, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Air Tech Limited Kg” L.L.C. has come to the decision to quit its nr. 811395971 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Gramoz Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të shkollës së mesme “7 Shtatori” Prishtinë.
- ▶ “F-MAX” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810195083
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

